# GAZETA SHQIPTARE








Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7658 E shtunë 22 Shtator **2018** **Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)**







Opinioni i Ditës

Është fakt sot një shqetësim tepër i shtuar për të ardhmen e BE-së. Ka kohë që BE bashkëjeton me krizën, që sot nuk e fshehin apo e mbulojnë dot ...

Vijon në faqen 21

Nga VASIL KURETA

## Situata brenda BE dhe e ardhmja e projektit europian





Opinioni i Ditës

Këtë të diel, më 23 shtator, me nismën e 10 gazetave më prestigjioze dhe disa sponsorëve në Gjermani do të zhvillohet edicioni i dytë i fushatës ...

Vijon në faqen 22

Nga JORGJI KOTE

## "Gjermania flet" 2018, po ne?



Lista me 31 toka, shtëpi dhe makina

# Ligji "Antimafia", vihen nën sekuestro miliona euro pasuri të Habilajve në Vlorë

Prokuroria e Krimeve të Rënda: Dyshohen për aktivitet në trafikim të lëndëve narkotike

TIRANË- Gjykata e Krimeve të Rënda ka pranuar kërkesën e Prokurorisë për sekuestrimin e pasurisë së grupit kriminal "Habilaj". Bëhet fjalë për 31 pasuri me vlerë disa miliona euro, të cilat u vunë nën sekuestro, në kuadër të hetimeve për dosjen që përfshin edhe ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri ...

Në faqen 6

KRYEPROKURORJA: REFUZIMI I SHORTIT, PA SHKAK. KANE DETYRIM LIGJOR

# DOSJA "SHULLAZI", ARTA MARKU PERPLASJE ME 10 PROKURORE

Kaos në institucion, vartësit nuk pranojnë short për çështjen: Është i paligjshëm. Tensioni, ndërhyn policia. Arta Marku cakton 4 prokurorët e dosjes



*(Në foto)* Kryeprokurorja e përkohshme, Arta Marku dhe prokurori, Sokol Stojani

Në faqet 2-3

DREJTESIA

## Urdhërarresti nga Belgjika, pranga Safet Bajrit, "të fortit të Shkodrës"

Në faqen 8

REFIMI NE "NEWS 24"

## Ekzekutimi i gruas, biznesmeni: S'e urdhërova unë, gënjejnë familjarët

Në faqen 7

PRANGA 2 SEKSEREVE

## Korrupsioni me pronat, ndalohet juristi i Hipotekës së Shkodrës

Në faqen 8

INTERVISTA

## Kritiku italian i artit në Tiranë: Ndërtimet e tri kohëve në Shqipëri

Në faqen 20

EMRAT E KANDIDATEVE



## Lista, datat për 860 mësues që do të hyjnë në provim, dokumentet që duhen

Në faqet 9-11

BLUE TOOTH

Rudina Xhunga i bashkohet grupit më të rëndësishëm mediatik në vend

# "Dritare" në 'News 24', risitë e sezonit të ri në TV

*Në brendësi: Surpriza e Elhaida Danit. Dasma "sekrete" e Elitës dhe Gjikos*

NGA PAMELA ALIAJ

Tashmë e dimë se shtatori është ashtuquajtur ndryshe 'motori i ndryshimit' ku personazhe të njohur të mediave ndryshojnë destinacionet e tyre duke nisur eksperienca të reja. Disa zhvendosen nga një media vizive në një tjetër,



disa largohen përfundimisht e disa rikthehen pas një periudhe shkëputjeje. Një ndër to është edhe gazetarja e njohur shqiptare, Rudina Xhunga. Prej pothuajse një sezoni nuk e shohim më pjesë të ekranit shqiptar, ndërkohë që vijon të jetë pjesë e pandarë ....

Suplement

# PROKURORIA
## PERPLASJET

### Tension mes Donika Prelës dhe vartësve për procedimin

# Përplasje mes prokurorëve te Krimet e Rënda, detyrohet të ndërhyjë policia

Revoltë te Krimet e Rënda. Një sherr i madh ka ndodhur dje në Prokurorinë e Krimeve të Rënda ku madje është thirrur për ndihmë policia. Çështja "Shullazi" ka ndezur gjakrat mes prokurorëve që refuzuan të uleshin në bankën e akuzës duke i kërkuar llogari drejtueses së Prokurorisë së Krimeve të Rënda Donika Prela për masat disiplinore.

Për të qetësuar situatën Prela ka thirrur policinë. Dy grupe të gatshme qëndruan te Krimet e Rënda deri në kthimin e gjendjes në normalitet.

Lëvizjet e fundit të befta në prokurori kanë sjellë një situatë aspak normale në organin e akuzës që përfaqëson shtetin. Dje Prokurorja e Përgjithshme Arta Marku urdhëroi caktimin e përkohshëm të 3 prokurorëve për Krimet e Rënda, në Berat, Pukë dhe Pogradec. Konkretisht Olsian Çela nga Prokuroria për Krime të Rënda, transferohet në Prokurorinë e Beratit. Ndërkohë Sonila Muhametaj nga Prokuroria për Krime të Rënda u transferua në Prokurorinë e Pukës.

Lëvizjet kanë prekur edhe Besim Hajdarmatajt, prokuror i çështjes "Tahiri", i cili është transferuar nga Prokuroria për Krime të Rënda në Prokurorinë Pogradec.

Po kështu Arta Marku kërkoi hetimin disiplinor të 10 prokurorëve që refuzuan gjykimin e çështjes 'Shullazi'.

**Klodiana Lala**

**PERPLASJA MARKU-STOJANI**

Kryeprokurorja e përkohshme kishte urdhëruar kreun e Drejtorisë së Inspektimit në Prokurori, Sokol Stojani që të hetonte 10 kolegët e tij, por ky i fundit nuk ka pranuar. Ndaj kryeprokurorja e përkohshme e ka lëvizur nga detyra Sokol Stojanin, por ende nuk dihet pozicioni i ri.



Prokuroria e Përgjithshme

"Refuzimi për dosjen Shullazi? Prokurorët caktohen në fillim, jo në fund"

# 10 prokurorë: Marku shkeli ligjin, nuk na transferon dot pa dëshirë

## Letër ankesë drejtuar ambasadave dhe PAMECA-s

Zbulohet letra e 10 prokurorëve për të cilët Prokurorja e Përgjithshme e përkohshme Arta Marku kërkoi hetim disiplinor. Letra i është dërguar mediave, zyrës së delegacionit të Bashkimit Europian në Republikën e Shqipërisë, Misionit PAMECA si dhe ambasadës amerikane. Ata tregojnë për mbledhjen e mbajtur më 29 shtator ku, siç pretendojnë, nuk janë njoftuar për objektin e saj.

Prokurorët deklarojnë se hedhja e shortit, dhe ideja vijuese për krijimin e një grupi hetimor prej 4 (katër) prokurorësh në gjykimin e një çështjeje penale, vinte në momentin kur çështja në fjalë ndodhej në fazën e diskutimeve përfundimtare, dhe grupet hetimore krijohen në fazën e hetimit dhe jo në fazën e gjykimit, aq më pak në fazën e diskutimeve përfundimtare. Një kërkesë e tillë, sipas tyre cenonte parimet e nenit 6 të ligjit nr. 97 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" në lidhje me pavarësinë dhe integritetin e prokurorëve, aq më tepër në një fazë të tillë të procesit, kur hetimi, akuzat, debati gjyqësor, qëndrimet mbi vlefshmërinë e provave dhe vlera e tyre provuese ishin kryer nga prokurorë të tjerë të çështjes. Argumentimi ligjor, parimor dhe mbi baza etike nga shumica e prokurorëve, nuk u mor parasysh nga drejtuesja e komanduar e PKR, e cila kërkoi ndërprerjen e menjëhershme të debatit, duke nisur procedurën e hedhjes së shortit.

"Duke u ndjerë në kushtet e paligjshmërisë së procesit, pjesa më e madhe prokurorëve, e përbërë nga 9 prej tyre, pasi paraqitën argumentet e tyre, dhe në mungesë vullneti nga drejtuesja e PKR për të diskutuar profesionalisht ligjshmërinë e procesit dhe argumentet, u larguan nga shorti. Në të njëjtën ditë, më datë 19 shtator 2018, grupi i 10 (dhjetë) prokurorëve u njoh me Njoftimin e Prokurores së Përgjithshme të përkohshme, për nisjen e një procesi disiplinor kundër tyre vetëm nëpërmjet mediave",-deklarojnë prokurorët.

Nga pjesa më e madhe e prokurorëve të pranishëm në mbledhje, u paraqitën pretendime në lidhje me kërkesën për hedhjen e shortit dhe ligjshmërinë e tij, pasi prokurorët e çështjes Elisabeta Ymeraj dhe Ened Nakuçi, vazhdonin të ishin prokurorë të çështjes, përfshirë këtu edhe prokurorin Besim Hajdarmataj, i cili në fakt, jo më herët se data 18 shtator 2018, përmes një akti me shkrim, i kishte shprehur drejtueses së komanduar të PKR vullnetin e tij, për të vazhduar përfaqësimin e çështjes në fjalë, pranë gjykatës kompetente.

"Hedhja e shortit, dhe ideja vijuese për krijimin e një grupi hetimor prej 4 (katër) prokurorësh në gjykimin e një çështjeje penale, vinte në momentin kur çështja në fjalë ndodhej në fazën e diskutimeve përfundimtare, dhe grupet hetimore krijohen në fazën e hetimit dhe jo në fazën e gjykimit, aq më pak në fazën e diskutimeve përfundimtare.

Një kërkesë e tillë, cenonte parimet e nenit 6 të ligjit nr. 97 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" në lidhje me pavarësinë dhe integritetin e prokurorëve, aq më tepër në një fazë të tillë të procesit, kur hetimi, akuzat, debati gjyqësor, qëndrimet mbi vlefshmërinë e provave dhe vlera e tyre provuese ishin kryer nga prokurorë të tjerë të çështjes",- thuhet në letrën e prokurorëve.

Ata shpjegojnë se për të garantuar pavarësinë e magjistratëve dhe mbrojtjen nga presionet mbi punën e tyre, ligji në fjalë nuk lejon asnjë transferim apo komandim të magjistratëve pa pëlqimin e tyre. "Cenimi i parimit të pavarësisë së prokurorëve, dëmton rëndë punën e këtij organi dhe ul besimin e publikut tek institucionet e drejtësisë",-deklarojnë ata.



Prokurori Besim Hajdarmataj

**10 PROKURORET**

- ➢ OLSIAN ÇELA
- ➢ PËRPARIM KULLURI
- ➢ ARENS ÇELA
- ➢ EDVIN KONDILI
- ➢ PRANVERA PUSTINA
- ➢ EUGEN BEÇI
- ➢ SONILA MUHAMETAJ
- ➢ BLERIM TOMINAJ
- ➢ BESIM HAJDARMATAJ
- ➢ BEHAR DIBRA

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

Kryeprokurorja: Procedim disiplinor për ata që refuzuan hedhjen e shortit

# Zhbllokohet dosja "Shullazi", Arta Marku cakton 4 prokurorët

## *Letra e paprecedent: Unë jam me mandat të përkohshëm, por krimi punon me kohë të plotë*



Prokuroria e Përgjithshme njoftoi dje gjetjen e grupit të prokurorëve që do të shpallin pretencën në gjyqit ndaj Emiliano Shullazit, Gilmando Danit, Blerim Shullazit, Endri Qyqes dhe Endri Zelës. Emrat e tyre nuk janë bërë publikë, por "GSH" mësoi se pjesë e grupit hetimor do të jenë drejtuesja e Krimeve të Rënda, Donika Prela dhe zëvendësi i saj, Gentian Osmani. Emërimi i tyre në dosjen "Shullazi" erdhi pasi njëri prej prokurorëve të çështjes, Nakuçi u largua jashtë vendit duke deklaruar se është i sëmurë, ndërkohë që Elisabeta Imeraj lëvizi në një detyrë tjetër. Një ditë më parë, kryeprokurorja e përkohshme, Arta Marku ka kërkuar hetim disiplinor për 10 prokurorë që refuzuan shortin. Bëhet fjalë për prokurorët Olsian Çela, Behar Dibra, Sonila Muhametaj, Arenc Çela dhe Edvin Kondili. Po ashtu, do hetohen edhe Pranvera Pustina, Eugen Beçi, Blerim Tominaj si dhe Besim Hajdarmataj. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, këta prokurorë refuzuan hedhjen e shortit në procedimin penal në gjykim në ngarkim të të pandehurve Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Endrit Qyqja, Endrit Zela dhe Blerim Shullazi, të cilët ndodhen pas hekurave për një sërë akuzash.

### REAGIMI I ARTA MARKUT

Prokurorja e Përgjithshme e përkohshme, Arta Marku ka reaguar pas ngjarjeve të ditëve të fundit në organin e akuzës, si në Prokurorinë e Përgjithshme, ashtu edhe në atë të Krimeve të Rënda dhe hetimin e kërkuar për 10 prokurorë. Marku tregon të vërtetën e saj për përplasjet me prokurorët dhe vartësit, të vërtetën e kësaj situate, siç thotë ajo, të sajuar nga frika e përballjes me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, pa dallim. Ajo deklaron se prokurorët e Krimeve të Rënda, ndaj të cilëve është urdhëruar fillimi i hetimit disiplinor, kanë refuzuar të marrin pjesë në hedhjen e shortit për të përfaqësuar në gjykim një çështje shumë sensitive për opinionin publik. Në këtë mënyrë, këta prokurorë sipas saj, kanë vepruar në kundërshtim me ligjin, që i detyron të jenë pjesë e shortit, duke vepruar në kundërshtim të hapur me detyrimin kushtetues.

### DEKLARATA E KRYEPROKURORES



Prokurorja e Përgjithshme e përkohshme, Arta Marku

**ARTA MARKU: PSE I PROCEDOVA PROKURORËT**

"Si Prokurore e Përgjithshme e përkohshme do të qëndroj fort dhe s'do tërhiqem në zbatimin e Kushtetutës dhe ligjeve të vendit tim, duke urdhëruar fillimin e hetimit disiplinor ndaj këtyre prokurorëve që kanë refuzuar të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre që iu ngarkon Kushtetuta dhe ligji", deklaroi Marku.

Të dashur qytetarë të vendit tim,

Në këto pak orë të ditës, duke filluar nga dje, e ndiej se si qytetarë të përgjegjshëm, jeni të shqetësuar nga një situatë absurdi dhe e pahijshme që është tentuar të krijohet në prokurorinë më të rëndësishme të vendit, Prokurorinë për Krime të Rënda. Me përgjegjësinë e detyrës që më ka ngarkuar Kushtetuta dhe ligji, kam detyrimin institucional dhe qytetar për të komunikuar dhe ndarë me ju dhe me këdo që i do të mirën këtij vendi, por edhe miqtë dhe partnerët ndërkombëtarë që asistojnë punën e institucionit të Prokurorisë në të gjitha nivelet, të vërtetën e kësaj situate të sajuar nga frika e përballjes me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, pa dallim.

Të dashur qytetarë,

Unë jam në detyrë me mandat të përkohshëm, por krimi i organizuar dhe korrupsioni ka mandat të përhershëm dhe punon me kohë të plotë. Për këtë arsye, është në detyrimin tim ligjor që të marr masat e nevojshme ligjore për cilindo prokuror apo oficer të Policisë Gjyqësore që refuzon pa asnjë shkak ligjor të ushtrojë detyrën dhe funksionin e tij kushtetues për të luftuar kriminalitetin dhe krimin e organizuar në veçanti dhe për më tepër, në prokurorinë më të rëndësishme në vend.

Prokurorët e Krimeve të Rënda, ndaj të cilëve është urdhëruar fillimi i hetimit disiplinor kanë refuzuar të marrin pjesë në hedhjen e shortit, për të përfaqësuar në gjykim një çështje shumë sensitive për opinionin publik. Në këtë mënyrë, këta prokurorë kanë vepruar në kundërshtim me ligjin që i detyron të jenë pjesë e shortit, për sa kohë janë prokurorë të asaj prokurorie, duke vepruar në kundërshtim të hapur me detyrimin kushtetues, sipas të cilit "Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit…".

Kjo, si dhe shkelja e rregullave të etikës janë arsyet e vetme që më kanë detyruar që si Prokurore e Përgjithshme e Përkohshme të qëndroj fort dhe të mos tërhiqem në zbatimin e Kushtetutës dhe ligjeve të vendit tim, duke urdhëruar fillimin e hetimit disiplinor sipas përcaktimeve të nenit 160, pika 5 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ndaj këtyre prokurorëve që kanë refuzuar të ushtrojnë përgje-gjësitë e tyre që iu ngarkon Kushtetuta dhe ligji. E ndjej si përgjegjësi kushtetuese, por edhe si detyrim qytetar, t'ju garantoj se përsa kohë do të jem në detyrën që më ka ngarkuar Parlamenti shqiptar, sovrani im dhe i juaji, të dashur qytetarë të vendit tim, unë jam e vendosur për të zbatuar pa hezitimin më të vogël Kushtetutën, ligjet në fuqi dhe Kodin e Etikës së Prokurorit dhe nuk mund të rri duarkryq kur prokurorët e shtetit refuzojnë të ushtrojnë funksionet e tyre kushtetuese dhe ligjore. Çdo prokuror që refuzon të bëjë detyrën do të përballet me përgjegjësi disiplinore, por edhe penale sipas rastit. Gjej rastin të falënderoj të gjithë prokurorët e ndershëm të sistemit të prokurorisë, por edhe ata prokurorë të Krimeve të Rënda që vazhdojnë të jenë në lartësinë e ushtrimit të detyrës që iu ka ngarkuar Kushtetuta dhe ligji dhe t'i garantoj se si Prokurore e Përgjithshme, për aq kohë sa do të jem në këtë detyrë të lartë dhe fisnike, do të jem gjithmonë krah tyre në këto ditë të vështira që po kalon sistemi. Së bashku do të vazhdojmë përballjen tonë me krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe me të keqen e këtij vendi, pa asnjë lloj ngjyre.

Unë do të vazhdoj me ju krah për krah, të bëj detyrën time me profesionalizëm dhe ndershmëri dhe dua të garantoj qytetarët shqiptarë se vendimmarrja ime nuk ka cenuar asnjë çështje, qoftë në hetim apo në gjykim, në Prokurorinë për Krime të Rënda. Për çështjen "Shullazi", ku një grup i caktuar prokurorësh refuzuan të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre kushtetuese dhe ligjore është caktuar një grup prokurorësh për të përfaqësuar akuzën në gjykim. Po ashtu, një grup tjetër prej 4 prokurorësh po merret me çështjen "Tahiri" nga momenti i regjistrimit të saj.

Të dashur qytetarë,

Për sa keni dëgjuar këto orët e fundit nga mediat dhe rrjetet sociale, nuk ka një të vërtetë tjetër përveç kësaj që unë sapo ju deklarova. Gjithçka tjetër është spekulim dhe frikë nga përballja me krimin e organizuar. Prokurorët e ndershëm që ka Shqipëria sot, më shumë se kurrë kanë nevojë jo vetëm për mbështetjen time, por edhe tuajën dhe unë jam e bindur se jemi në anën e duhur, jemi në anën e së mirës. Së bashku do ta fitojmë betejën me krimin.

*Faleminderit!*

*Arta Marku*

### Sokol Stojani refuzon hetimin e "10 prokurorëve", Marku e shkarkon

"Balkanweb" publikoi dje urdhrin e Arta Markut për Sokol Stojanin, "rebelin" që i doli kundër Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme në lidhje me hetimet disiplinore ndaj prokurorëve dhe detyra të tjera të përcaktuara nga ajo. Marku ka urdhëruar lirimin nga detyra të Stojanit, i cili mbante postin e drejtorit të Drejtorisë së Ndihmës për Subjektet e Posaçme, Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, Studimeve, Projekteve në Prokurorinë e Përgjithshme. Urdhri i kryeprokurores mban datën 19 shtator, pra dy ditë më parë. Stojani e kishte marrë detyrën më 24 janar të këtij viti, kur Prokurorja e Përgjithshme, Marku paraqiti ndryshimet në strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme. Siç u raportua në atë kohë, ndryshimet u kryen pas këshillimeve me drejtorët e drejtorive dhe të përputhshmërisë në zbatim të paketës së re të Reformës në Drejtësi. Gjithashtu, ndryshimet u bënë në mbështetur në rregullimin e veprimtarisë së prokurorisë nga kjo reformë, sipas dispozitave kalimtare të Ligjit 97/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorë-ve". Kaloi në rang drejtorie Ndihma për Subjektet e Posaçme, Mbrojtja e Dëshmitarëve, Inspektimit, Studimeve dhe Projekteve, ku në krye u vendos prokurori Sokol Stojani.


SHPALLJE ANKANDI
Datë 24.09.2018, Ora 16:00
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e tretë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Enkelea Shaban Novaku dhe dorëzanësit Adriatik Sefer Novaku:
-"Truall" me sipërfaqe 100 m2 dhe "Ndërtesë me 3 kate me sipërfaqe 90 m2 secili, nr. i pasurisë 4/106, zona kadastrale 8581, vol. 13, faqe 69, adresa: Lagja Nr. 1, Pogradec.
Çmimi fillestar i ankandit të tretë është në shumën 6 552 000 (gjashtë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.



SHPALLJE ANKANDI
Datë 24.09.2018, Ora 16:45
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të dorëzanësit Baftjar Alush Murto:
-"Truall+Ndërtesë" me sipërfaqe trualli 300 m2 dhe ndërtesë 81 m2, regjistruar në regjistrin hipotekor me volum nr. 3, faqe 76, zona kadastrale 3316, nr. i pasurisë 987, adresa: Shalës, Sarandë.
Çmimi fillestar i ankandit të parë është në shumën 1 440 000 (një milion e katërqind e dyzet mijë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.



**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**
**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**
PASURIA ME NR. 27/1, E LLOJIT 'ARË', VOLUMI 1, FAQJE 169, ZONA KADASTRALE 3852, SIPËRFAQJE 4.453 m2, NË ADRESËN: XHAFZOTAJ, DURRËS, NË PRONËSI TË Z. NEXHMI VORA,
**ÇMIMI 17.600.000 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 08.10.2018.**
**CEL. 0684026666 ; 0693262866 .**

SITUATA POLITIKE

DEBATI

Voller dhe Pack, kritika Shqipërisë: Krimi pengon integrimin, sjell destabilitet

# Përfaqësuesit e PPE: "Peshqit e mëdhenj" i çoni para drejtësisë

## *"Marku po i nxjerr jashtë loje prokurorët"*

Valentina Madani

PPE përmes të dërguarve të saj në Tiranë, në Konferencën Ndërkombëtare për Ballkanin me temë "30 vjet më pas" dha alarmin se situata e krimit në Shqipëri është e rrezikshme dhe po pengon integrimin e shqiptarëve. Këtë shqetësim ngritën dy prej përfaqësuesve të lartë të PPE, sekretari për Marrëdhëniet me Jashtë, Patrick Voller dhe presidentja e Grave të Partisë Popullore Europiane, Doris Pack. Ata vunë në dukje se me krim të organizuar që i sjell Shqipërisë dhe Europës destabilitet, integrimi europian do të vonohet edhe më shumë. "Dekriminalizimi i politikës është kyç për Shqipërinë dhe ligjet e miratuara duhet të vihen në zbatim", - u shpreh Voller, i cili vuri komentoi me tone kritike ngjarjet e fundit në prokurori. "Forcimi i shtetit të së drejtës, lufta kundër korrupsionit, pavarësia në sistemin gjyqësor duhet të shënojë progres, por transferimi i prokurorëve siç ndodhi dje, nuk është një shenjë e mirë", - tha Voller. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar mbeten dy kërkesa themelore, në mënyrë që Shqipëria të bëjë përpara me negociatat vitin e ardhshëm. "Le të themi se 'peshqit e mëdhenj' dhe të paprekshmit duhet të çohen përpara drejtësisë", - u shpreh Sekretari për Marrëdhëniet me Jashtë në Partinë Popullore Europiane. Akoma më mosbesuese dhe kritike ndaj qeverisë së Ramës është presidentja e Forumit të Grave të PPE, Doris Pack, e cila vuri në dukje se Shqipëria ka bërë hapa prapa dhe shprehu shqetësim për veprimet e papranueshme të prokurorisë për mbylljen e dosjeve "Tahiri" dhe "Shullazi". "Kryeprokurorja e përkohshme po i nxjerr jashtë loje prokurorët që duhet të përballen me kriminelë të rrezikshëm dhe i dërgon ata në detyra të tjera. Ky është një simbol që tregon për veprime për të mosrespektuar drejtësinë dhe për t'i shpëtuar daljes para gjykatës dhe sigurisht, që është diçka që s'mund të pranohet", - tha presidentja e Forumit të Grave në PPE. Ajo foli edhe për situatën e rëndë të krimit në Shkodër, duke vënë në dukje ekzistencën e bandave mafioze, vrasjeve, pengmarrjeve, situatës së rëndë të krimit në Vlorë dhe mosveprimit të qeverisë për të siguruar jetën e njerëzve. Duke iu referuar këtij realiteti, Doris Pack ishte kritike me kolegët e saj europianë. "Shpesh ndihem e turpëruar për gjithçka çfarë ka ndodhur në vitet e fundit dhe nuk janë marrë në konsideratë nga jashtë. Zyrtarët e BE-së kanë thënë vetëm që vendi është në rrugë të mbarë e kështu me radhë, në vend që të vendosnin gishtin në plagë. Kjo ka qenë e turpshme dhe para zgjedhjeve të vitit të kaluara, i vetmi zë në Perëndim që fliste për kanabisin këtu isha unë. Nuk është se jemi kundër dikujt, por se jemi në favor të njerëzve që jetojnë në këtë vend", - u shpreh presidentja e Forumit të Grave të PPE, Doris Pack. Patrick Voller dhe Doris Pack morën pjesë në konferencën ballkanike me temë "30 vjet më pas. Çfarë e mban Ballkanin jashtë BE. Roli i Gruas në procesin e Integrimit", e organizuar nga Lidhja Demokratike e Gruas së Shqipërisë dhe Forumi i Gruas së Partisë Popullore Europiane me mbështetjen e fondacioneve "Konrad Adenauer" dhe "Hanns Seidel".



Presidentja e Grave të Partisë Popullore Europiane, Doris Pack dhe sekretari për Marrëdhëniet me Jashtë, Patrick Voller

**DORIS PACK**

"Kryeprokurorja e përkohshme po i nxjerr jashtë loje prokurorët që duhet të përballen me kriminelë të rrezikshëm dhe i dërgon ata në detyra të tjera. Ky është një simbol që tregon për veprime për të mosrespektuar drejtësinë dhe për t'i shpëtuar daljes para gjykatës dhe sigurisht, që është diçka që s'mund të pranohet", - tha Pack.

## Franca skeptike, ambasadorja Vasak: Bisedimet varen nga reformat

Pak ditë pas Gjermanisë, një tjetër vend i Bashkimit Europian shprehet skeptik për rrugëtimin e Shqipërisë drejt hapjes së negociatave. Gjatë konferencës Ndërkombëtare për Ballkanin, ambasadorja franceze Christina Vasak, një nga vendet që nuk ndezi dritën jeshile për nisjen e bisedimit të integrimit të Shqipërisë, i ka bërë thirrje politikes shqiptare të angazhohen për të pasur rezultate konkrete nga reformat e ndërmarra. Në këtë mënyrë, edhe një herë është vënë në dyshim marrja e një vendimi pozitiv në qershor. "Shqipëria është në pritje të hapjes së negociatave me Bashkimin Europian në qershor të vitit të ardhshëm. Por, për të pasur një përgjigje pozitive nga vendet skeptike duhet të plotësohen kriteret që i janë dhënë Shqipërisë për të hapur rrugën europiane", deklaroi zj.Vasak. Ndërsa, kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Bujar Leskaj u shpreh se institucionet që përfaqëson mbështet vetingun në drejtësi, por që ky proces të jetë i plotë, sipas tij duhet të materializohet ndëshkueshmëria me ligj. "Asnjë reformë apo proces në Shqipëri, përfshirë dhe procesin e vetingut, të cilin ne si KLSH e mbështetin plotësisht, nuk do të arrijë të zbatohet plotësisht dhe reforma në drejtësi të luftojë me efektivitet dhe eficencë korrupsionin, në rast se nuk materializohet me ligj të qartë, përgjegjësia e shkelësve dhe abuzuesve të pronës shtetërore", theksoi z.Leskaj. Konfrontimet dhe pakënaqësitë mes KLSH-së dhe organeve të drejtësisë vijojnë prej kohësh. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka akuzuar organin e akuzës se ka pushuar pa i hetuar kallëzimet penale.







Gjatë një seance parlamentare



**TEATRI**

Presidentja e Grave të PPE-së, Doris Pack dhe deputetja e PD Albana Vokshi u bën mbrëmë pjese e protestës së artistëve kundër shembjes së Teatrit Kombëtar.

**DITMIR BUSHATI**

"Si anëtar i kabinetit shpreh gjithë solidaritetin tim për punën e forcave të sigurisë. Sikundër nuk diskutohet që është përgjegjësi e autoriteteve përkatëse për të marrë masa korrigjuese, aty ku forcat e zbatimit të ligjit nuk funksionojnë siç duhet. Është kënaqësi për mua të dëgjoj që Doris Pack edhe pse sot është në pension, ka pasur mundësi të jetë si një vizitore në Shkodër, pa pasi Shkodra simbolizon gjithçka".

### Deputeti i PD, akuza kryeprokurores për krimin

## Bylykbashi: Marku ka shpartalluar prokurorinë, hetimet të jashtëligjshme

Deputeti demokrat, Oerd Bylykbashi, i ftuar dje në "News 24" foli pas "furtunës" në prokurori nga prokuroja e përgjithshme, Arta Marku. Vendimin për të hetuar 10 prokurorë nga Marku, deputeti demokrat e quan plotësisht antikushtetues. Sipas Bylykbashit, me vendosjen e saj në krye, Arta Marku ka shpartalluar Kryeprokurorinë duke vepruar vetëm për interesat e qeverisë. Deputeti opozitar e cilëson gjendjen aktuale të vendit më të keqe se ajo e '97-ës përsa i përket kolapsit të krijuar "në një vend pa gjykata". "Në krye të këtyre 9 muajve, kjo është krijesa që na lindi, kjo prokurore erdhi aty për të shpartalluar prokurorinë dhe për ta vendosur në duart e qeverisë. As në '97-ën nuk ka ndodhur kjo gjë me prokurorinë. Ishte një nga trupat më të mirë që kishim, por tani është shpartalluar nga Arta Marku, e paligjshme në atë detyrë. Kryeprokurore të përkohshme nuk gjendet askund në Kushtetutë. Ka bërë veprime aktive me lëvizje në kundërshtim me ligjin. Nuk ia lejon ligji të bëjë ato lëvizje që ka bërë. Është haptazi që po i bën përgjegjësi penale të rënda vetes. Ne e kemi kallëzuar Markun për veprimet antiligjore. Ligji sot ia kufizon prokurorit të përgjithshëm deri sa të ngrihen organet për të larguar prokurorët. Prokuroria e Krimeve të Rënda është në kolaps. Janë veprime të qëllimshme për të mbyllur çështjet më të bujshme që i bien Edi Ramës. Problemi është që po kolapsin prokuroria. Prokuroria kur ka organe të këtij lloji, mund edhe t'i arrestojë policët. Jemi përpara dështimit të organit të pavarur. Gjërat që po ndodhin deri më sot tregojnë që reforma në drejtësi ka dalë nga binarët. Sa kohë kanë shqiptarët për të pritur të ardhmen e tyre?! Po zvarriten gjërat. U emëruan njerëz me veto nga UNM. Vetë Arta Marku e ka kaluar vetingun me notën kalueshëm, edhe pse është në majë të Kryeprokurorisë. Me këtë dhunë të Arta Markut ndaj prokurorëve elitë, do bëhet ajo që do qeveria", tha Bylykbashi.



Kreu i PD reagon ashpër për ndëshkimin e 10 prokurorëve: Po mbyllet dosja "Tahiri"

# Basha, akuza Markut: Shërbëtore e Ramës, po liron Shullazin

## "Ligji antimafia, do konfiskohen asetet kriminale"

Valentina Madani

Kryetari i opozitës, Lulzim Basha i ftuar në konferencën ballkanike "30 vjet pas'. Çfarë e mban Ballkanin jashtë BE?" garantoi se realizimi i vetingut në politikë është zgjidhja e vetme që garanton ndarjen e krimit nga politika. Basha u shpreh i bindur se PD do të bëjë gjithçka që ta realizojë këtë nismë. Kreu i opozitës paralajmëroi se shumë shpejt PD do të prezantojë amendimin e ligjit antimafia, me anë të cilit do të konfiskohen asetet kriminale dhe do të hetohen të gjitha koncesionet. "Vetingu politik është zgjedhja që kemi propozuar dhe jemi të gatshëm ta realizojmë atë. Ndërkohë, do të prezantojmë projektligjin antimafia, me anë të cilit do të verifikohen të gjitha koncesionet dhe do të konfiskohen asetet kriminale", tha Basha. Nga konferenca ballkanike që organizoi Lidhja Demokrate e Gruas, bashkëpunimi me Forumin e Gruas së PPE që po zhvillohet në Tiranë, Lulzim Basha komentoi situatën e krijuar në organin e akuzës, ndërsa akuzoi Arta Markun se po lë pa prokuror çështjen "Tahiri" dhe "Shullazi", ndërsa theksoi se po përgatitet lirimi i këtij të fundit. "Lidhja e politikës me krimin është pengesa kryesore për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Provat e mbrëmshme janë tronditëse, prokuroria e kapur politike, shërbëtorja e Edi Ramës me një të rënë të lapsit ka lënë pa prokuror çështjen e Saimir Tahirit dhe çështjen e Emiljano Shullazit. Siç kemi paralajmëruar, roli i saj është të shkatërrojë hetimet kryesore të politikanëve të lidhur me krimin dhe të banditëve të lidhur me politikën. Prokuroria sot është në mbrojtje të Saimir Tahirit, Fatmir Xhafajt, Jurgis Çyrbjes. Është bërë gati lirimi i Shullazit, mikut të Tahirit dhe mikut të mikut të Ramës. Është liruar Ermal Hoxha, i dënuar në rastin e fabrikës së kokainës së Xibrakës për sjellje të mirë, sepse nuk nxori emrin e Olsi Ramës, vëllait të kryeministrit, si një nga personat e përfshirë në fabrikën e kokainës në Xibrakë", theksoi z.Basha. Ai akuzoi se krimi ka marrë kontrollin e qyteteve, sepse ka bekimin e ministrit të Brendshëm. "Paratë publike përfundojnë në kontot bankare të politikanëve të korruptuar dhe kriminelëve të lidhur me ta përmes tenderave dhe PPP-ve, që në shumicën e rasteve përfundojnë në duart e personave me precedentë të tmerrshëm kriminalë. Njerëz të dënuar në Itali, Greqi, SHBA, Holandë, Gjermani për trafik droge në kundërshtim me ligjet e vendit fitojnë qindra miliona euro tendera nga qeveria e Edi Ramës". Basha denoncoi edhe dje miratimin nga Kuvendi të dy ligjeve, atë për lojërat e fatit dhe ndërtimin e Teatrit të ri Kombëtar. Sipas kreut demokrat, këto dy ligje legjitimojnë pastrimin e parave të krimit përmes lojërave të fatit dhe sektorit të krimit. Në këtë pikë, ai kishte një thirrje për zyrtarët e BE. "Atëherë le t'u bëjmë thirrje atyre që flasin në emër të Europës, të mos na gënjejnë më, të mos flasin me patate në gojë, por ta thonë qartë: Europa nuk i toleron politikanët e lidhur me krimin dhe vendet që qeverisen nga politikanë të lidhur me krimin nuk kanë për të ecur përpara", u shpreh z.Basha.


Kreu i PD-së, Lulzim Basha

**AKUZA**

"Shërbëtorja e Ramës dje me një të rënë të lapsit la pa prokurorë çështjen e Tahirit dhe Shullazit. Sot prokuroria po mbron Saimir Tahirin, Xhafajn, po bëhet gati lirimi i Shullazit. U lirua Ermal Hoxha, sepse nuk nxori emrin e Olsi Ramës. Krimi ka marrë dhenë, sepse ka bekimin e Ramës dhe Xhafajat", deklaroi z.Basha.

### Opozita kërkon edhe largimin e kryeprokurores

## Opozita padit Markun: Largoi prokurorët që hetojnë Tahirin

Opozita i cilëson lëvizjet e paligjshme të prokurorëve të urdhëruara politikisht. Ajo bëri dje kallëzim penal ndaj kryeprokurores Arta Markut për shpërdorim detyre, pasi ajo vendosi sipas saj të shpërbëjë tërësisht grupin e prokurorëve të çështjes penale ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. "Arta Marku ka ndërhyrë në mënyrë aktive për dështimin e hetimeve ndaj tij", - shprehet opozita në kallëzimin penal. "Fillimisht largoi nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, duke komanduar si drejtuese e Prokurorisë së Tiranës, znj. Elisabeta Imeraj. Më pas, transferoi edhe prokurorin tjetër të çështjes, z. Besim Hajdarmataj nga Prokuroria e Krimeve të Rënda në Prokurorinë e Pogradecit. Lëvizja dhe transferimi i prokurorëve që udhëheqin çështjen penale të Saimir Tahirit është një veprim aktiv dhe i kundërligjshëm, që bëhet me qëllimin e plotë të dështimit të hetimeve dhe përbën pa asnjë dyshim pengim të drejtësisë. Kjo lëvizje vjen në një kohë ku afati ligjor i hetimeve është drejt përfundimit dhe prokurorët do të duhet të dalin me konkluzionin përfundimtar mbi këtë hetim", - thuhet më tej në kallëzimin e depozituar në Prokurorinë e Tiranës dhe që mban firmën e dy kryetarëve të grupeve parlamentare, ai i PD-së Edmond Spaho dhe ai i LSI-së Petrit Vasili. Në kallëzimin penal theksohet gjithashtu se, "akte të tilla të paligjshme nga Arta Marku provojnë tërësisht se qëllimi i saj në detyrë është shërbimi politik ndaj Edi Ramës dhe dështimi apo pengimi i hetimeve ndaj zyrtarëve të lartë të kësaj qeverie apo organizatave kriminale të lidhura me të". Duke qenë se Arta Marku drejton prokurorinë dhe kallëzimi është bërë tek vartësit e saj në Prokurorinë e Tiranës, opozita ka kërkuar njëkohësisht edhe marrjen e masës së përkohshme të pezullimit nga detyra deri në përfundimin e hetimit.



**"KUFIJTË"**

"Propozimi për shkëmbimin e territoreve është legjitimim i aventurierëve dhe legjitimim i pesë bandave të krimit të organizuar në veri dhe në jug të lumit Ibër. Në qoftë se ka vullnet politik për të çmontuar këto pesë banda të krimit të organizuar në jug dhe në veri të lumit Ibër, atëherë alibia e fundit për mosfunksionim të territorit të Kosovës bie", tha z.Basha.

### Vetingu në polici, mblidhet nënkomisioni

## Felaj: Prokuroria e pavarur, lëvizjet e Markut të ligjshme

Për PS-në, të gjitha vendimet e kryeprokurores Arta Marku janë të ligjshme. Deputetja e mazhorancës, Ermonela Felaj deklaroi se çuarja për procedim disiplinor të 10 prokurorëve të Krimeve të Rënda është tërësisht ligjor. "Unë shoh që është marrë një masë dhe ka pasur një përgjigje për situatën që është bërë prezente. Është masë e ligjshme. Nxisim që efektiviteti i tyre të jetë më i lartë", tha zj.Felaj. Ajo komentoi edhe akuzat e opozitës në adresë të kryeprokurores Arta Marku. "Prokuroria është organ i pavarur. Opozita ka qenë pjesëmarrëse në mbledhjen e Komisionit të Ligjeve dhe i ka drejtuar shqetësimet e veta", u shpreh deputetja e PS-së. Mazhoranca mblodhi dje nënkomisionin për zbatimin e vetingut në radhët e policisë, që ishte kërkuar nga opozita, por që nuk ka qenë e pranishme në mbledhjen e tij të parë. Kryetare e këtij nënkomisioni u zgjodh Ermonela Felaj, ndërsa anëtarë nga radhët e mazhorancës u zgjodhën Pjerin Ndreu, Elona Gjebrea dhe Sadi Vorpsi.

## Vasili, Markut: E gjunjëzuar para Ramës deri në poshtërim

Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, reagoi dje në lidhje me deklaratën e Kryeprokurores së Përgjithshme, Arta Markut, e cila sqaroi situatën e krijuar tek Krimet e Rënda. Vasili në një postim në "Facebook" shkruan se deklarata e Markut është antiligj dhe thjesht një diarre rilindase. "Shqipëria ka kryeprokuroren më mjerane dhe më të kapur të 100 viteve të fundit. E gjunjëzuar përpara kryeministrit deri në poshtërim, kryeprokurorja ka zgjedhur të rrëzojë prokurorinë në prehrin e krimit dhe të kryeministrit të kriminalizuar", shkruan z. Vasili.



Prokuroria: Nën sekuestro apartamente, ndërtesa, troje, garazhe e makina luksoze

# Trafikimi i narkotikëve, sekuestrohen miliona euro pasuri të grupit të Habilajve

## *Pronat, të Ciko, Moisi, Artan, Florian Habilajt, Fatmir Minajt dhe personave të tjerë*

**TIRANË**

Gjykata e Krimeve të Rënda ka pranuar kërkesën e Prokurorisë për sekuestrimin e pasurisë së grupit kriminal "Habilaj". Bëhet fjalë për 31 pasuri me vlerë disa miliona euro, të cilat u vunë nën sekuestro, në kuadër të hetimeve për dosjen që përfshin edhe ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Pronat që janë sekuestruar janë të familjes Habilaj, përkatësisht Ciko, Moisi, Artan dhe Florian Habilajt, por edhe të Fatmir Minajt dhe personave të tjerë, që dyshohet se janë të implikuar në trafikun e lëndëve narkotike. Me kërkesë të organit të akuzës janë sekuestruar 10 apartamente, 4 ndërtesa, 5 makina, 1 garazh dhe truall mijëra euro. Në njoftimin e prokurorisë thuhet se vendimi për sekuestron u mor pas konstatimit se Nazer Seitaj, Moisi Habilaj dhe Florjan Habilaj ushtronin aktivitet kriminal në fushën e trafikimit të narkotikëve, bashkë me persona të tjerë.

### NJOFTIMI I PROKURORISË

Në datë 29.04.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë regjistroi procedimin penal Nr.164/2017 për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve", në bashkëpunim, e parashikuar në nenin 283/a paragrafi 2 i Kodit Penal. Regjistrimi i këtij procedimi u bë mbi bazën e informacioneve referuese të shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Seksionit kundër Narkotikëve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, sipas të cilëve shtetasit Nazer Seitaj, Moisi Habilaj, Florjan Habilaj ushtronin aktivitet kriminal në fushën e trafikimit të narkotikëve.

Në datë 25.09.2017, duke arsyetuar se disa prej personave që hetoheshin në kuadër të procedimit penal Nr.134/2016 (ndërkohë që për disa prej tyre, Taulant Haxhiraj Shkëlqim Koçiaj, Xhovalin Baco, Marjus Bajrami, Reshat Radhima etj., u përfunduan hetimet dhe çështja u paraqit për gjykim) ishin të përfshirë edhe në trafikimin e lëndëve narkotike së bashku me shtetasit Moisi Habilaj, Florian, Habilaj, Nazer Seitaj dhe Matan Matani, bazuar në nenin 79 germa "b" të Kodit të Procedurës Penale, prokurori vendosi bashkimin e procedimeve Nr.134/2016 dhe Nr.164/2017 në një procedim të vetëm, Nr.134/2016.

Në datë 17.10.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, regjistroi procedimin penal Nr.313/2017 për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve", kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal dhe "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë ose i të zgjedhurve vendorë", të parashikuar respektivisht nga nenet 283/a paragrafi 2, 333/a dhe 260 të Kodit Penal, duke urdhëruar njëkohësisht regjistrimin e emrit të shtetasit Saimir Tahiri si person nën hetim për llogari të këtij procedimi.

Regjistrimi i procedimit të mësipërm u bë mbi bazën e të dhënave të përftuara nga media, në lidhje me faktin e arrestimit nga autoritetet italiane të drejtësisë të shtetasit Moisi Habilaj, si pjesë e një grupi kriminal, që ushtronte aktivitet në fushën e trafikimit të narkotikëve. Sipas informacionit referues, që parapriu regjistrimin e procedimit, rezultoi se arrestimi i shtetasit Moisi Habilaj u krye në kuadër të hetimit në vazhdimësi nga autoriteti i drejtësisë italiane, në lidhje me faktin e sekuestrimit të sasisë prej 3.5 tonë lëndësh narkotike. Si rezultat i hetimeve të kryera (gjithmonë sipas informacionit referues) u arrit të zbulohej se personi nën hetim, Moisi Habilaj, së bashku me persona të tjerë kishin bashkëpunuar me ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Në datë 18.10.2017 u vendos bashkimi i këtij procedimi me procedimin Nr.134/2016. Me këtë të fundit u bashkuan edhe aktet e dërguara për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në lidhje me faktin penal, të gjetjes, në datë 01.11.2017, të sasisë së eurove në mjetin e drejtuar nga Orest Sota.

### PRONAT E SEKUESTRUARA

Pas kërkesës të paraqitur nga ana e Prokurorisë për Krime të Renda Tiranë (Baza ligjore; nenet 3-7, 11, 12, 14 dhe 15 ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë), nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë është vendosur:

Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe sekuestrimin e pasurive të mëposhtme.

1.Pasuria ndërtesë me sipërfaqe 156m², e cila figuron në pronësi të shtetasit Artan Habilaj, i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.2688 Rep. dhe 1787/2 Kol. datë 12.09.2014, me vlerë 40.000 euro.

2. Pasuria garazh me sipërfaqe totale 514m², e cila figuron në pronësi të shtetasit Artan Habilaj, i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.2689 Rep. dhe 1788/2 Kol. datë 12.09.2014, me vlerë 60.000 euro.

3. Pasurinë apartament me sipërfaqe totale 77.7m², e cila figuron në pronësi të shtetasit Artan Habilaj, me kontratën e shitjes Nr.3533 Rep. dhe Nr.2290/1 Kol. datë 18.11.2014, me vlerë 3.000.000 (tre milionë) lekë.


Ish-shefi i Policisë së Kufirit Sokol Bode me Moisi Habilaj

4. Pasuria apartament me sipërfaqe totale 40.95m², e cila figuron në pronësi të shtetasit Ciko Habilaj, i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.3534 Rep. dhe Nr.2291/1 Kol. datë 18.11.2014, me vlerë 2.080.000 (dy milionë e tetëdhjetë mijë) lekë.

5. Pasurinë apartament me sipërfaqe totale 40.95m², e cila figuron në pronësi të shtetasit Ciko Habilaj, i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.3534 Rep. dhe Nr.2291/1 Kol. datë 18.11.2014, me vlerë 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

6. Pasurinë apartament me sipërfaqe totale 102m², e cila figuron në pronësi të shtetasit Moisi Habilaj, i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.2696 Rep. dhe Nr.1344/1 Kol. datë 04.07.2011, me vlerë 4.000.000 (katër milionë) lekë.

7. Pasuria apartament me sipërfaqe totale 285m², e cila figuron në pronësi të shtetasit Artan, Moisi dhe Florian Habilaj, të cilët e kanë blerë me kontratën e shitjes Nr.2698 Rep. dhe Nr.1345/1 Kol. datë 04.07.2011, me vlerë 20.000.000 (njëzet milionë) lekë.

8. Pasurinë truall me sipërfaqe totale 580m², e cila figuron në pronësi të shtetasve Artan, Moisi dhe Florian Habilaj, të cilët e kanë blerë me kontratën e shitjes Nr.727 Rep. dhe Nr.305 Kol. datë 27.04.2016, me vlerë 205.000 euro.

9. Pasurinë ndërtesë me sipërfaqe totale 67m²,e cila figuron në pronësi të shtetasve Artan, Moisi dhe Florian Habilaj, të cilët e kanë blerë me kontratën e shitjes Nr.726 Rep. dhe Nr.304 Kol. datë 27.04.2016, me vlerë 45.000 euro.

10. Pasurinë njësi me sipërfaqe totale 136 m²,e cila figuron në pronësi të shtetasit Florian Habilaj, i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.390 Rep. dhe 167 Kol. datë 08.03.2017, me vlerë 170.000 euro.

11. Pasuria njësi me sipërfaqe totale 157m², e cila figuron në pronësi të shoqërisë "TURI&MZB" sh.a..

12. Pasurinë apartament me sipërfaqe totale 71.5 m², e cila figuron në pronësi të shtetases Zenepe Habilaj, e cila e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.646 Rep. dhe 539 Kol. datë 22.04.2009, me vlerë 3.150.000 (tre milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

13. Një apartament me sipërfaqe 69m², ndodhur në lagjen "Uji i ftohtë", Vlorë, me vlerën 25.000 euro. Nga dokumentacion i administruar rezulton se shtetasja Klementina Habilaj (bashkëshortja e shtetasit Artan Habilaj), me kontratë paraprake shitjeje Nr.742 Rep dhe Nr.484 Kol. datë 04.04.2016, e ka blerë nga shoqëria "AFA Konstruksion" sh.p.k.

14. Pasuria 19/140+2-7, Z.K.8604, vol.37 fq.40, e llojit apartament, me sipërfaqe 104.5m², e cila figuron në pronësi të shtetasit Fatmir Minaj, i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.883 Rep. dhe 456/1 Kol. datë 30.07.2013, me vlerë 5.400.000 (pesë milionë e katërqind mijë) lekë.

15. Mjeti me targë - AA900NF, e markës "Audi", modeli A8, e vitit të prodhimit 2008.

16. Pasuri e paluajtshme në emër të Artan Ciko Habilaj për të cilën ka aplikuar për legalizimin e një objekti sipas kërkesës me nr.977 datë 03.10.2014, me nr.1216 prot. datë 08.02.2017, me nr.2030 prot. datë 09.08.2017.

17. Pasuri i e paluajtshme në emër të shtetasit Moisi Ciko Habilaj, i cili ka aplikuar për legalizimin e një objekti sipas kërkesës nr.305 datë 19.06.2013 me vendndodhje pylli i Sodës, Vlorë, ndërtesë 1 kat me sipërfaqe trualli 300m², kërkesë nr.4798 prot. datë 22.01.2015 dhe nr.2029 prot. datë 09.08.217.

18. Pasuri e paluajtshme në emër të shtetasit Florian Ciko Habilaj, ka aplikuar për legalizimin e një objekti sipas kërkesës nr.2002 prot. datë 07.08.2017, me nr.2031 prot. datë 09.08.2017, me nr.2032 prot. datë 09.08.2017 dhe nr.2003 prot. datë 09.08.2017.

19. Për pasuritë e luajtshme dhe konkretisht mjeteve me targa:

20. Automjetin me targë - AA900NF, e markës "Audi", modeli A8, e vitit të prodhimit 2008.

21. Automjetit me targë AA 221 GJ.

22. Automjetin me targë AA 265 HF.

23. Automjetin me targë AA 933 JE.

24. Automjetin me targë AA 997 JT.

25. Pezullimin e pasojave të vendimit 379 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë deri në dhënien e një vendimi gjyqësor penal për pasuritë e mëposhtme:

26. Pasuria njësi me sipërfaqe totale 157 m², e ndodhur në lagjen "28 Nëntori", Vlorë, e cila figuron në pronësi të shoqërisë "TURI&MZB" sh.a..

27. Pasuria njësi me sipërfaqe totale 136m², e ndodhur në lagjen "28 Nëntori", Vlorë, e cila figuron në pronësi të shtetasit Florian Habilaj.

28. Pasuria apartament me sipërfaqe totale 77.7m², e cila figuron në pronësi të shtetasit Artan Habilaj.

29. Pasuria me sipërfaqe 69m², apartament banimi në lagjen "Uji i ftohtë", Vlorë, ndërtuar nga shoqëria "AFA Konstruksion" sh.p.k. kontraktuar nga shtetasja Klementina Habilaj në datë 04.04.2016.

30. Pasuria sipërfaqe 104.5m², e ndodhur në Vlorë, në pronësi të shtetasit Fatmir Minaj.

31. Pasuria ndërtesë me sipërfaqe 156m², e ndodhur në lagjen "28 Nëntori", Vlorë, e cila figuron në pronësi të shtetasit Artan Habilaj.

Pasuritë e sekuestruara kanë një vlerë të konsiderueshme (disa miliona euro). Hetimet lidhur me procedimin penal nr.134 të vitit 2016 vazhdojnë.

**STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON"**
**me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA**
**Dt. 25.09.2018 ora 16:00**
**Përfundon Ankandi i Parë për pasuritë:**
*- Pasuria "Lokal nr.4" me sip.66 m2, me adresë L.13, Plazh Durrës.*
***Me çmim 66 000 Euro***
*- Pasuria "Lokal nr.5" me sip.43 m2, me adresë L.13, Plazh Durrës*
***Me çmim 51 600 Euro***
*-Pasuria "Lokal nr.6" me sip.110 m2, me adresë L.13, Plazh Durrës*
***Me çmim 140 800 Euro***
**Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Blv.kryesor (ish kinma iliria) ,Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575**

albius
**Zyra e Përmbarimit Albius**, me përmbarues gjyqësor privat Zef Macaj, në bazë të vendimit nr. 1857, datë 19 Shtator 2018, shpall shitjen në ankand të pasurisë pasurisë "Ndërtesë", me sipërfaqe 115 m2, me numër pasurie 6/596/ND, volumi 37, faqe 111, zona kadastrale nr. 8120, me adresë : Rr. " Niko Avrami", Tiranë, në vlerën **43, 361.6 (dyzet e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një, pikë gjashtë) Euro**.

Ankandi zhvillohet në ambjentet e Zyrës të Përmbarimit Albius, në adresën : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa nr. 6, Hyrja nr. 3, Apartamenti nr. 8, Njësia Administrative nr. 10, 1001, Tiranë, ditën **e Enjte**, me datë **19 Shtator 2018**, ora **16.15**.

Ne kuader te zbatimit te projektit te dixhitalizimit te sherbimit noterial kombetar per venien ne funksionim te databazes shteterore NISA, Dhoma Kombetare e Noterise (DH.K.N.) fton Operatoret Ekonomike te huaj ose vendas per te marre pjese ne kete procedure.
Dokumentat e projektit mund te terhiqen perkundrejt pageses prej **10.000 leke,** prane Dh.K.N. ne adresen Rruga Vaso Pasha, Tirane, Shqiperi.
Propozimet do te pranohen brenda dates **7 tetor 2018 ora 10:00 AM**

I dënuari me burgim të përjetshëm flet për "News 24": Jam i pafajshëm, kërkoj drejtësi

# Ekzekutimi i 39-vjeçares në Shkodër, biznesmeni Sadetin Sula: Suela ishte thesari im

## "Nuk kam urdhëruar vrasjen. Familjarët e gruas më akuzojnë dhe më morën fëmijët, pasi duan pasurinë"

TIRANË

Sadetin Sula, i cili është dënuar me burg për jetë për urdhërimin e vrasjes së gruas së tij ka thyer heshtjen ndërsa mohon krimin. Në një lidhje telefonike drejtpërdrejtë nga burgu 313 për emisionin "Me zemër të hapur" në "News 24", biznesmeni nga Shkodra tha dje se nuk fshihej pas vrasjes së gruas, Suelës, të cilën e cilësoi thesar dhe frymëzim. Teksa drejtoi gishtin e akuzës nga familjarët e ish-bashkëshortes së tij, ai tha se pasi e dënuan padrejtësisht, shteti i mori edhe fëmijët. Ngjarja e rëndë për të cilën u dënua biznesmeni ka ndodhur dy vite më parë. 39-vjeçarja Suela Sula u gjend e pajetë më 18 prill të 2016-ës, në ambientin e tualetit të mobilierisë në Shkodër, që ajo kishte së bashku me bashkëshortin e saj. Ndërkohë, avokati mbrojtës i Sulës, Theodhori Sollaku pohoi se kjo çështje është paragjykuar që në fillim nga gjykata dhe prokuroria. Ai pohoi se ndaj klientit të tij kishte vetëm disa indicie dhe jo prova, ndërsa tha se do të luftonte për pafajësi të Sadetin Sulës. "Një gjë mund të them, çështja është e rëndë dhe kërkon impenjim maksimal. As akuza dhe as gjykata nuk e morën seriozisht këtë çështje. E paragjykuan që në fillim. Shkeljet janë flagrantë. Ka pasur një ngutje. Bëhet fjalë për indice, por jo për prova. Organi i procedurës ka detyrë të hetojë dhe jo vetëm prova në favor të akuzës. Janë kapur disa foldera, kur aty mund të ketë me dhjetëra foldera. Më e bukura është se ato incizime janë 8 muaj para ngjarjes. Nuk ka prova. Çështja është e pastër për pafajësi dhe do kurajë nga ana e prokurorëve dhe gjyqtarëve. Shpresoj që vetingu t'i japë atë që i takon Sadetin Sulës, 'Çezarit t'i jepet ajo çka i takon'", deklaroi Sollaku.

"Gazeta Shqiptare" zbardh të plotë intervistën e Sadetin Sulës me gazetaren Evis Ahmeti.

**Cila është e vërteta?**

Faleminderit për emisionin! Dua që të sensibilizoj popullin shqiptar. Vinë në biznes dhe vrasin gruan time. Fëmijët e mi s'e di ku ndodhen. Mua më mbajnë në paraburgim dhe më japin burgim të përjetshëm. Kjo që më ndodhi mua, mund t'i ndodh çdokujt si popull i thjesht.

**Si e keni mësuar ju ngjarjen? Ishit i pari që e gjetët të pajetë gruan. Si ishin marrëdhëniet?**


# Shkon në mes të Parisit, por i ndodh e papritura. Çfarë i ndodh Armina Mevlanit?




Prej disa ditësh blogerja e njohur, Armina Mevlani ndodhet në Paris. Në një nga eventet më të rëndësishme të modës, Armina s'kishte se si të mungonte. Ajo ka ndarë në rrjetet sociale një video gazmore. 'Unë duke u përpjekur të jem seksi, dështova' shkruan Armina në videon e publikuar. Armina për pak sa nuk u rrëzua para aparateve që filmonin dhe shkrepnin foto.

# E pyesin për vajzat e bashkëshortit, rrëfehet Zaimina: "S'kam dashur t'i bëj publike, por..."

Vetëm para disa muajsh, këngëtarja Zaimina Vasjari përjetoi një nga gëzimet më të mëdha në jetë. Ajo u bë nënë për herë të parë dhe solli në jetë vajzën e saj Khloe nga martesa me partnerin Klodian Asllani. Edhe pse këngëtarja ka dashur ta mbajë larg syve të medias lidhjen e saj të dashurisë dhe sidomos marrëdhënien me vajzat e partnerit, e ftuar në "Wake Up" ajo ka zbuluar më tepër rreth lidhjes me to. "Kam një marrëdhënie jashtëzakonisht shumë të bukur. Ato janë vajzat e bashkëshortit tim, por janë edhe gjaku i vajzës sime dhe motrat e saj. Ato janë pjesë e familjes dhe janë dy vajza të mrekullueshme. Unë nuk kam dashur t'i bëj publike, sepse sot mund të aludohet shumë. Unë kam pasur edhe shumë mesazhe jo shumë të këndshme rreth kësaj teme, prandaj dua që privatësia e jetës së tyre të jetë larg vëmendjes së mediave. Me ardhjen në jetë të Khloes ato janë shumë pranë me njëra-tjetrën edhe pse gocat jetojnë jashtë vendit",- ka thënë Zaimina.







# Provokon keq Damiano i "Big Brother", shfaqet me 5 vajza topless në dhomë

Edhe pas famës së fituar nga reality show i njohur, "Big Brother 9", Damiano Agalliu gjithnjë është shquar për postime apo deklarata që kanë shkaktuar reagime. Këtë herë ai ka publikuar në rrjetin social 'Instagram' foto ku shfaqet në një dhomë me 5 vajza topless dhe me armë në dorë. "Lufta e 3 botërore sapo nisi", - shkruan ai krahas fotos. Ende s'dihet nëse ai ka nisur xhirimet për klipin e tij të radhës pasi ka realizuar disa të tillë apo është thjesht një provokim i radhës i Damianos.








# "Faleminderit që ekzistoni!", Seldin s'e lënë të qetë as pas ndarjes

Tashmë prej disa muajsh u përfol për një ndarje të mundshme të këngëtarëve Seldi Qalliu dhe Mimoza Shkodra. Zërat do të qarkullonin kudo derisa pak ditë më parë, në "Dance with me", Seldi do t'i konfirmonte përfundimisht: "Jo nuk jemi më bashkë. Kështu paska qenë e shkruar. Gëzoj shumë respekt për Mimozën dhe familjen e saj. "Fjalët qarkulluan me shpejtësi dhe sigurisht u shkrua sërish rreth ndarjes, këtë herë të zyrtarizuar! Pas vërshimit të lajmeve nga mediat rozë, Seldi nuk ka vonuar të thumbojë disa njerëz specifikë, siç vetë ai iu adresohet. "Janë disa njerëz specifikë në këtë botë që na duan aq shumë saqë i harrojnë "hallet" e veta dhe merren me "hallet" tona. Faleminderit që ekzistoni se pa ju do ishim shumë të qetë dhe s'do kishim stres." S'është aspak e lehtë për personazhet e njohur, kështu që as Seldi nuk ka se si të shpëtojë.

INTERVISTA

# ALESANDRO GALLICCHIO:

## Përballja me arkitekturën e së shkuarës

Fatmira Nikolli

### *Nga Qendra "Pompidu" për ndërtimet e tri kohëve në Tiranë*

Dua të shoh edhe se si populli shqiptar ka një sens përkatësie mbi arkitekturën italiane, atë socialiste dhe me qytetin global të ditëve tona. Nëse duket se gjithçka ka ardhur nga jashtë, atëherë si vendësit janë përshtatur me to? Nëse Politekniku është një arkitekturë italiane, ka një element të kullës shqiptare. Ndaj, duhet kuptuar se në ç'mënyrë kjo duhet integruar në imagjinatën e qytetit që jeton".

Allesandro Galliçhio ka qëndruar 10 ditë në Tiranë në rezidencë te "Harabel" për të parë se si bashkëjetojnë qytetarët me arkitekturën e tri kohëve në vendin tonë. Ai punon për "Institute Nacional de Histoire de Art" dhe për Qendrën 'Pompidu' në Paris. Studimi për arkitekturën në Tiranë, është një kërkim postdoktoral që financohet nga 'Labex', laboratorë ekselence që quhen LabexCap dhe zgjat një vit. Ai nuk është limituar me këtë kërkim, por bashkë me gjeografin njohës të Ballkanit, Pierre Santes (Profesor i gjeografisë kulturore), kanë nisur një projekt që titullohet "Monumed", që kërkon të dijë se si monumentet e reja reagojnë sot në hapësirën mesdhetare. Ka punuar në Sarajevë dhe pas Shqipërisë vazhdon. Kërkimi i tij do të botohet në revistën "Chaciers du CAP".

**- Gjatë këtij kërkimi, çfarë keni mundur të kuptoni jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për artin?**

Lidhja e Shqipërisë me Italinë është në shumë mënyra e fortë. Ndaj kam shumë miq shqiptar. Kam ardhur me miqtë për herë të parë në 2014-ën. Nuk dija asgjë për këtë vend. Duke ecur dhe duke vizituar jugun a Tiranën kam kuptuar që jo vetëm në aksin kryesor, por edhe përtej tij ka një lloj prezence italiane që për mua ishte familjare, që është arkitektura e viteve 1930 përveç asaj të viteve 1920, me impiantin urbanistik, tipik i një qyteti modernist italian, ndërtuar gjatë periudhës së Musolinit, dhe pra, gjatë pushtimit italian në Shqipëri. Kjo, ishte diçka që nuk e prisja kurrë, nuk kisha dijeni për këtë.

**- Sa dije për vendin?**

Pak. Fillova të vij rregullisht vitet e para, e sa më shumë vija shihja një lloj transformimi të rëndësishëm të Tiranës. Si historian arti dhe kurator e njihja Tiranën falë videos së Anri Sala "Dammi i colori", që mes të tjerash kur isha në Palazzo Stroci në Firence, e kisha ekspozuar dhe e njihja mirë.

Me kalimin e viteve kuptova që jo vetëm fasadat e kishin ndërruar disi imazhin e Tiranës, por edhe ndërhyrjet publike po ashtu dhe këtu flas për ndërhyrje artistike që e kishin modifikuar hapësirën. Kur mbarova doktoraturën, vendosa të ndërmerrja një studim për Tiranën.

**- Në çfarë konsiston studimi juaj?**

Studimi përqendrohet të vëzhgimi se si hapësira urbane e Tiranës ka ndryshuar nga fillimi i shekullit të 20-të e deri tani. Studimi merret me evoluimin, arkitekturën italiane, integrimin artistik italian, gjithë periudhën socialiste (komuniste) që është më pak e studiuar, e për të parë sot se si arti kontemporan në këtë vazhdimësi historike, ndërhyn e futet në hapësirën urbane. Në këtë kuadër do shihen edhe marrëdhëniet mes artit, hapësirës urbane, qytetit dhe shoqërisë e për të parë po ashtu se si kjo po ndërtohet sot në Shqipëri, sepse Ballkani në përgjithësi e Shqipëria në veçanti, mund të jetë një shembull unik, sepse mund të na thotë shumë edhe për vende e qytete të tjera në Amerikën Jugore dhe Europën e vjetër që po ndryshon për shkak të procesit të modernizimit urban. Është ky dialog që më intereson.

**- Për disa prej nesh, kjo ndërthurja mes pallateve të larta e vilave të vogla, që rrinë pranë e pranë janë një lloj kaosi. Tanimë të para nga syri i një studiuesi, si duken?**

Kërkimi im nuk ka mbaruar akoma, do ta publikoj pas disa muajsh. Për këto ndërtime, unë nuk kam një rezultat. Por, sa u takon akseve kryesore, ku gjen vepra të artit bashkëkohor që u shtohen aspekteve të tjera, mendoj se janë një prej rasteve më interesante për t'u analizuar sepse gjejmë, një përkohshmëri historike që zgjat një shekull, rigjejmë të gjitha gjuhët formale që vijnë së pari nga italianët, më pas nga ndikimi rus, më pas nga ndikimi kinez e sot nga ndikimi i botës së globalizuar. Sepse kur shohim instalacione që mund të shihen në Nju York dhe Buneos Aires ose në Paris, është një çështje që në mes të kërkimit tonë, sot qyteti mund të jetojë, të mbijetojë dhe mund të modifikohet, mund të reagojë me këtë botë të globalizuar.

**- Cilat janë veprat e artit bashkëkohor për të cilat flisni?**

"Reja" e Fuojimotos, Bunkeri, vetë bulevardi dhe sheshi, "Markiza" e Philip Parreno pranë kryeministrisë, "Bunkart 2" e të tjera.

Ajo që më intereson nuk është vetëm të analizoj këto ndërhyrje që janë mjaft evidente, por edhe të ribëj një historik të të gjitha ndërhyrjeve që janë bërë që 1998 deri më sot. Ndaj, takimi me artistë që janë të interesuar te hapësira urbane, te kjo hapësirë urbane, por në një mënyrë të ndryshme, alternative e me një estetikë, që nuk e ndryshon rrënjësisht qytetin, por që punon me qytetin. E nis me Bienalet e Tiranës që janë bërë. Çfarë ndodhte në hapësirën urbane? Mbase nuk shihen ndërhyrjet si ato që përmenda, por janë ndërhyrje të bëra. I rëndësishëm është edhe dialogu që është bërë, jo vetëm trashëgimia historike e ajo që është ende sot, por edhe ato ndërhyrje që mbase kanë impaktin viziv më të vogël, por që kanë qenë vërtet të rëndësishme për këtë territor. Sipas meje, në këtë dialog mund të kuptohet diçka më shumë, mbi vizionin unik dhe për të kuptuar se Tirana është një bashkim i gjithë kësaj. Në këtë vazhdë, dua të shoh edhe se si populli shqiptar ka një sens përkatësie mbi arkitekturën italiane, atë socialiste dhe me qytetin global të ditëve tona. Nëse duket se gjithçka ka ardhur nga jashtë, atëherë si vendësit janë përshtatur me to? Nëse Politekniku është një arkitekturë italiane ka një element të kullës shqiptare. Ndaj, duhet kuptuar se në ç'mënyrë kjo duhet integruar në imagjinatën e qytetit që jeton. Nuk është vetëm imazhi i rëndësishëm, por edhe se si ky imazh jeton me shoqërinë. Ky është objekti im i analizës: të shoh se si këto territore bartin të ndryshmet. Janë territore me përkohshmëri të ndryshme. Ndaj rigjen periudhën fashiste, edhe atë të komunizmit dhe atë që ka sot një qytet global. Është e rëndësishme që të mos ndalemi vetëm në një vizion të njëkohshëm, por duhet parë në kompleks. Ndaj, trashëgimia kulturore shqiptare është thelbësore.

**- Cila është qasja në Itali ndaj arkitekturës së periudhës fashiste?**

Kjo është shumë interesante. Unë jetoj në Paris, sepse punoj në Qendrën "Pompidu", jap mësim në universitet dhe bëj kërkime. Ndaj më intereson tani të shoh trashëgiminë. Është në një sens një trashëgimi, që i takon një periudhe historike të komplikuar të një regjimi totalitar dhe nga ana tjetër ka ndërtuar gjithë urbanistikën e shekullit të XX në Itali. Për italianët, modernizmi dhe arkitektura moderniste fashiste ekziston, por nuk është kaq thelbësore. Parë në një sens, ato janë forma arti, arkitektë që kanë eksperimentuar në disa forma në një moment historik të vështirë, por që përfaqësojë një lloj avangarde për Italinë. Qytetarët italianë, përveç disa rasteve natyrisht, e jetojnë këtë hapësirë dhe e jetojnë në mënyrë natyrale.

Nga SHBA dhe perëndimi, kjo është parë si diçka që mund të vihet në diskutim. Departamenti i Italianistikës në 'Nju York University' ka publikuar një artikull mbi "skandalin" siç e quajtën, mbi zonat ku estetika fashiste me mbishkrime fashiste që janë akoma në këmbë në Itali, kur të gjitha skulpturat e Leninit kanë rënë në ish-bllokun lindor. Në realitet, këto leksione mbi arkitekturën nuk lidhen gjithmonë me estetikën apo me një domethënie të caktuar politike.

**Ka përjashtime edhe në Itali.**

Por shpesh debatet janë politike. Një parti kërkon të hiqet një piedestal në Breshia e një parti kërkon të rrijë. A është arti bashkëkohor një përgjigje, një alternativë për këto debate? Nuk e di, me këtë merret këtë çështje.

**-Studimi që po bëni për Shqipërinë ku do të publikohet?**

Do publikohet në "Chaciers du CAP", revistë e laboratorit të ekselencës që del një herë në vit e ku tregohen kërkimet vjetore të të rinjve që punojnë me këto institucione.



Alessandro Galicchio, historian arti

## Kishat e Voskopojës dhe Vithkuqit në UNESCO?

Ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro dhe drejtoresha e Institutit të Monumenteve, Arta Dollani pritën në një takim pune misionin e ekspertëve të "Europa Nostra"-s, përfaqësuar nga anëtari i bordit, Paolo Vitti dhe Peter Bond dhe Lourdes Llorens Abando, ekspertë teknikë nga Banka Europiane e Investimit. Sipas një njoftimi të zyrës së shtypit të Ministrisë së Kulturës, pas vizitës kishat e Voskopojës dhe Vithkuqit, Vitti u shpreh i mrekulluar për vlerat arkitektonike dhe artistike që përcjellin këto monumente të kulturës, frymëzuar nga trashëgimia e kultit bizantin, duke i cilësuar "Thesare Unike" në rajon e më gjerë. Sipas të njëjtit njoftim, misioni u shpreh entuziast dhe sugjeroi përgatitjen e dosjes që këto kisha të vlerësohen me statusin e mbrojtjes si trashëgimi botërore nga UNESCO. "Trashëgimia Kulturore nuk është luks, por potencial për zhvillim ekonomik. Qeveria shqiptare prej pesë vitesh ka kthyer fort vëmendjen ndaj trashëgimisë kulturore. Programet si "100 Fshatrat", apo "Rrugët e Besimit" nuk janë vetëm sensibilizim ndaj pasurive kulturore, natyrore dhe shpirtërore të Shqipërisë, por një itinerar i pasur i këtyre thesareve që presin të zbulohen për të komunikuar kulturalisht, por edhe për të gjeneruar ekonomi lokale", - u shpreh Kumbaro gjatë takimit. Misioni vlerësoi punën e Ministrisë së Kulturës dhe Institutit të Monumenteve në mirëmbajtjen, restaurimin dhe vëmendjen e treguar ndaj këtyre monumenteve dhe u shpreh i gatshëm të "krijojmë urat e nevojshme të komunikimit dhe bashkëpunimit në nivel institucional".



Opinioni i Ditës

# Situata brenda BE dhe e ardhmja e projektit europian

Nga Vasil Kureta

*(vijon nga faqja 1)*



... por më e keqja është se klasat politike dhe strukturat e BE nuk dinë ç'të bëjnë me krizën. Ka më shumë zhurmë e protoganizma individuale e spontane, sa i përket përballimit të krizës, por realisht nuk ka asnjë vizion të plotë për përmbajtjen e krizës, por sidomos ndonjë program konkret për përballimin dhe kapërcimin e saj. Ka shashka gjithfarë lloji, si ato për "më shumë Europë", apo "Europa me dy shpejtësi", apo me rrathë etj., por tashmë edhe opinione e sjellje që e dëshirojnë një fund të BE, që shfaqen në formën e të kritikuarit të strukturave të BE, por edhe ëndrra që presin një fund të BE. Klasat politike të vendeve të BE duken si të dorëzuara përballë kësaj krize, apo shumë të dobëta përballë presioneve të nacionalizmit e sovranizmit, që godet integrimin e bashkimin.

Në kushtet e një dorëzimi faktik përballë krizës, në vend që të përqendrohen te thelbi i projektit e përmbajtja e krizës, dëgjohen pohime të tipit një Europë më konkurruese, apo një Europë që mbron, deri dhe koncepte për një Europë të krishterë e me shtete sovrane. Këto koncepte tregojnë paaftësi për të kuptuar thelbin e projektit europian e për ta përmbushur atë. Për të kuptuar më mirë situatën ndihmojnë edhe ata që kritikohen nga strukturat e BE për defekte të rënda, sa i përket marrëdhënies me sistemin e vlerave, apo që kanë shfaqje domethënëse e shqetësuese të mosfunksionimit të demokracisë e sundimit të ligjit, që kritikojnë strukturat e BE, sepse u kërkojnë të jenë korrektë me sistemin e vlerave, që është bazamenti mbi të cilën funksionon modeli perëndimor europian. Madje, ka edhe opinione, që një Europë më të integruar e konsideron thjesht një makth. Për të gjitha këto arsye, BE shfaqet sot realisht jofunksionale. Duket që nuk ka siguri e sikur jemi përpara kapitullimit të ecurisë së projektit europian apo të një triumfi të euroskepticizmit. Nëse përpara pak kohësh flitej për dy shpejtësitë, sot problemi është bërë më serioz, sepse po kërcënohet realisht e ardhmja e projektit europian. Përmbajtja aktuale e krizës së BE dëshmon cilësinë e marrëdhënies që klasa politike e vendeve të BE ka me thelbin e përmbajtjen reale të projektit europian. Në hapësirën e BE po zhvillohet fenomeni i humbjes së terrenit politik të partive tradicionale dhe i rritjes së peshës reale të partive antiestablishment. Votuesit europianë vërtet e mbështesin projektin europian, por shfaqen të lodhur me politikat shumëvjeçare të partive tradicionale. Ky proces zhvillohet në kushtet kur dallgët e nacionalizmit, që po godasin hapur sistemin e vlerave, bazamentin e BE e projektin europian po fuqizohen, harmonizohen e organizohen në emër të një Europe të re. Partitë tradicionale, mbështetëse të fuqishme të projektit europian erdhën duke e zvogëluar mbështetjen në elektorat dhe parti nacionaliste e euroskeptike kanë rritur mbështetjen nga elektorati. Qytetarët europianë akoma nuk po e kuptojnë se çfarë po ndodh me projektin europian e të ardhmen e tij, madje edhe një pjesë kanë mbështetur partitë që synojnë fenomenin "exit", si në Angli.

Parti të ekstremit të djathtë kanë siguruar mbështetje, edhe pse ato cenojnë dhe godasin rëndë funksionimin e sistemit të vlerave, dmth., bazamentin e modelit perëndimor të zhvillimit e të BE. Zhvillimet brenda BE kanë evidentuar qartë kontradiktën apo alternativën: një BE më e bashkuar apo një shpërbërje e heshtur e saj. Ka tregues të qartë, që partitë me orientim nacionalist e sovranist synojnë gjithnjë e më hapur të godasin identitetin europian, i cili është një sintezë vlerash e formuar historikisht, e pasuruar përmes sendërtimit të sistemit të vlerave dhe në proces përkryerje të pandërprerë. Ky identitet dhe sistemi i vlerave kanë shërbyer si një ushqim bashkues e integrues, duke e bërë më cilësor e më të fuqishëm identitetin europian. Identiteti europian është pasuruar nga ecuria e projektit europian dhe ka mundësuar një afrim ekonomik, politik, shpirtëror, social, mendor, psikologjik të popujve europianë, duke ndjerë vazhdimisht goditje nga brenda dhe jashtë, por edhe i ndikuar nga efekte të krizës ekonomike e ngecjes reale të avancimit të projektit europian. Frymëzimet nacionaliste e sovraniste hapur nxisin e ushqejnë konceptin apo mendësinë më shumë nga "unë" se nga "ne", më shumë nga interesat e shtetit komb se sa nga interesat e përbashkëta europiane. Partitë nacionaliste, në goditjet që i japin projektit europian sjellin "argumentin" se nuk po mbrohen sa duhet vlerat tradicionale të kombit konkret, apo që në rastin e përballimit të krizës së refugjatëve, nuk po mbahet parasysh elementi kristian i besimit. Zhvillimi i identitetit europian e ka bërë sot realisht hapësirën europiane multikulturore, tolerante, solidare, të hapur ndaj respektimit të vlerave njerëzore. Partitë nacionaliste synojnë të ushqejnë një kontradiktë mes identitetit europian e atij kombëtar, duke shfrytëzuar veçanërisht një problematikë konkrete ekonomike e sociale, edhe për shkak të goditjeve të krizës botërore ekonomike e financiare. Tashmë është më se e qartë se brenda BE ka fragmente që iu rri ngushtë shumë sistemi i vlerave, prandaj dhe evidentohen të grindur ndaj kërkesave të strukturave të BE për zbatimin e standardeve e rregullave të dakordësuara, shfaqin defekte në realizimin e standardeve të funksionimit të demokracisë, sundimit të ligjit apo të lirive e të drejtave të njeriut etj. Madje, konstatohet edhe paradoksi se këto fragmente në vend që të forcojnë standardet e vlerat demokratike e të shtetit juridik, kanë rritur kritikat ndaj strukturave të BE, që insistojnë te standardet demokratike. Tash konstatohen edhe përpjekje nga parti me frymëzim nacionalist, që të organizohen në synimin e mbrojtjes së koncepteve e mendësive që i kundërvihen hapur funksionimit të BE, mbështetur në sistemin e vlerave.

Madje, ka edhe përpjekje për të "argumentuar" këtë pozicion nacionalist në formën që e mendon BE si një aleancë ekonomike e mbrojtëse e kombeve të pavarura, pa eregulla të përbashkëta ligjore. Sipas këtij koncepti, çdo vend ka të drejtën e vet të krijojë sistemin ligjor, sipas traditave të veta. Sipas kësaj mendësie, do të ketë një BE pa kufizime demokratike, por një lloj aleance të lirshme shtetesh krejtësisht të pavarura, pa detyrime politike të bashkësisë. Kjo mendohet si një "Europë e re", një aleancë që ribalancon marrëdhëniet mes vendeve anëtare dhe institucioneve të BE. Sipas këtij koncepti, identitetet kombëtare do të mbrohen dhe e ardhmja e BE nuk është e paracaktuar. Ky koncept mendon një identitet krejt tjetër nga filozofia e ideatorëve të projektit europian. Siç shihet, ky koncept nacionalist bie ndesh me thelbin e filozofinë e projektit europian, që udhëhiqet nga sistemi i vlerave, standardet e përbashkëta të zhvillimit, solidariteti, integrimi. Manfred Veber ka të drejtë kur nënvizon se: "Nuk kemi nevojë për Europë tjetër, tashmë ekziston një BE. Një Europë e nacionalizmit dhe egoizmit nuk mund të funksionojë dhe të punojë për të mirën e qytetarëve".

Është fakt që frymëzimet aktuale nacionaliste e sovraniste synojnë të godasin identitetin europian, thelbin e përmbajtjen e BE, filozofinë e projektit europian. Ato nuk njohin e nuk pajtohen me evoluimin e përmbajtjes së identitetit europian, të pasuruar gjatë procesit të integrimit. Sistemi i vlerave sendërton shpirtin e vërtetë europian. Pikërisht këtu qëndron solididiteti, forca e modelit perëndimor e europian të zhvillimit dhe po kështu, baza e së sotmes dhe së ardhmes së projektit europian. Është vërtet absurd, por fakt, që sot ka edhe koncepte që orientimin dhe mbështetjen e sistemit të vlerave e konsiderojnë si orientim apo qeverisje e majtë e BE. Po kështu, sjellja e partive nacionaliste drejtohet kundër insistimit të strukturave të BE për respektimin e sistemit të vlerave, të standardeve të funksionimit të demokracisë dhe shtetit juridik.

Nuk mund të mos tërheqë vëmendjen fakti që tashmë nuk ka thjesht qëndrime konkrete të partive apo pozicione të veçanta, por ka edhe përpjekje për bashkim forcash mes nacionalistëve për t'iu kundërvënë hapur sistemit të vlerave. Kjo nuk mund të kuptohet ndryshe, veçse si një thirrje e orientim për të ndryshuar BE, për t'u drejtuar kundër projektit europian dmth., kundër modelit perëndimor të zhvillimit. Nëse vërtet do të mundësohet një ditë një bashkim i këtyre forcave nacionaliste anti-BE, kjo do të jetë një ditë e zezë për BE, për modelin europian e perëndimor të zhvillimit, për vetë fatet e njerëzimit. Vitet '30 të shekullit të kaluar as nuk mund të kthehen, as nuk duhet lejuar të përsëriten. Thirrja më e fundit për bashkim të partive nacionaliste, populiste e euroskeptike vjen edhe nga Le Pen në Francë e jo vetëm nga italiani Salvini, që ka deklaruar se po punon me parti e qeveri të djathta, kundër asaj që e quan një qeverisje e majtë nga BE sot.

Salvini mendon se hapja e procedurës ligjore ndaj Hungarisë, sipas nenit 7, sa i përket zbatimit të principeve të demokracisë e sundimit të ligjit, janë një akt politik, një çmenduri e Europës së majtë! Ai shpreh bindjen se vitin tjetër do të ndryshojmë plotësisht Europën, duke përjashtuar socialistët nga qeverisja e saj. Ne - ka nënvizuar ai - jemi duke punuar me parti të tjera dhe qeveritë europiane, për të ndryshuar historinë e këtij kontinenti në maj. Kjo deklaratë e zëvendëskryeministrit italian nuk është as për t'u mbivlerësuar e as për t'u nënvlerësuar. Ajo që bie në sy është gjuha populiste, edhe pse kjo masë drejtohet ndaj mënyrës së qeverisjes hungareze e jo ndaj popullit hungarez. Po kështu, ajo është një procedurë juridike e jo një akt politik. Edhe deklarimi se vitin që vjen do të ndryshojmë plotësisht Europën, duke përjashtuar socialistët nga qeverisja e Europës, është gjithashtu jo demokratike e jo në përputhje me sistemin e vlerave. Këto deklarime duken si thirrje të hapura për t'u koordinuar rreth një ofensive kundër sistemit të vlerave, kundër BE, kundër modelit europian e perëndimor të zhvillimit. Siç shihet, përmbajtja e krizës së BE është pasuruar mjaft dhe ka prirje të zgjerohet. Kriza e BE është sot një fenomen mjaft negativ, që po pasuron më tej përmbajtjen dhe kërcënon për pasoja më të rënda e negative. Kapërcimi i krizës së BE është sot një detyrim madhor për klasën politike europiane e përgjegjësi e rëndë përballë historisë e popujve europianë.

Kjo krizë nuk mund të zgjidhet as duke e soditur, as duke bërë sikur po njihet dhe trajtohet, as duke bërë retushime e propozime të dështuara në thelb, as duke u dorëzuar, as duke ecur me konceptin 'të vemi ku të vemi' apo 'të shpëtojmë ç'mund të shpëtojmë', as me konceptin 'një hap para e dy hapa prapa'. Jo, ajo kërkon një shkundje të fortë, reflektim shumë më të përgjegjshëm, programim serioz e shkencor të punës, angazhim serioz të kërkimit shkencor, bashkim forcash, qëndrim të bashkuar. BE u fut në situatë krize edhe nga ngurrimi për të ecur përpara më me guxim e vendosmëri. Vetëm përpara, prapa është gremina e pashmangshme. Jashtë projektit europian, BE nuk ka të ardhme.

Merkel është shumë e qartë që në këtë moment të krizës së BE-së e vë theksin te stabiliteti dhe të qëndruarit të bashkuar, si BE dhe si perëndim. Kriza e BE zgjidhet duke i treguar realitetin dhe ndërgjegjësuar të gjithë elektoratin dhe sidomos brezin e ri, që duket se nuk kanë një njohje të saktë të gjendjes. Kriza zgjidhet vetëm duke parë dhe ecur vetëm përpara. Zgjidhja e saj kalon nga nxitja më tej e ecurisë së projektit europian, kalon nga thellimi e avancimi i këtij projekti të madh civilizues. BE edhe pse sot gjendet në krizë, është një histori suksesi e evolucionit të shoqërisë njerëzore, histori e ndërtimit të një modeli, që ka në themel dhe udhëhiqet nga sistemi i vlerave, paqja, solidariteti, liria, demokracia e dinjiteti njerëzor, sundimi i ligjit dhe përgjegjshmëria e lartë historike. Kriza e BE dhe një problematikë brenda saj po ndodh në një moment kur ka realisht një grindje brenda Perëndimit, ku ka një problematikë konkrete në marrëdhënien mes SHBA dhe BE, që duket se do të stimulojë edhe një ndryshim të kësaj marrëdhënieje. Disa e mendojnë si një përsosje të aleancës perëndimore, por ka edhe pesimistë që shohin një rrezik real të së ardhmes së saj. Ka kontradikta reale, por as që mund të mendohet se ndodhemi përballë të një fundi të kësaj marrëdhënieje apo vjetrim të saj. Ka sot që mendojnë se nuk ka një grindje të thjeshtë brenda Perëndimit, por një kontradiktë të mprehtë në zhvillim, që ka krijuar një hendek mes SHBA dhe BE. Ajo që po ndodh sot është një proces i ndryshimit të disa ekuilibrave, që kanë funksionuar deri më sot, por që nevojitet të përsosen, të ndryshohen apo t'u hapin rrugë ekuilibrave të rinj. Nuk ka sot asnjë krizë serioze të Perëndimit dhe sidomos nuk ka sot një krizë të modelit të zhvillimit perëndimor. Modeli perëndimor është më i avancuari, më efektivi, më afër dinjitetit njerëzor, që nuk mund të konkurrohet nga modelet e tjera eklektike apo autoritariste. Aleanca euroatlantike u formësua historikisht, mbështetur në sistemin e vlerave dhe natyrën e përbashkët dhe pasuroi përmbajtjen në kushtet ne përballjes frontale mes dy kampeve e modeleve të kundërta të zhvillimit.

Pas rrëzimit të komunizmit, duket se formati perëndim po i nënshtrohet procesit të përsosjes, që evidenton edhe nevojën e dialogut, kooperimit, por jo të konfrontimit. Nuk ka sot realisht krizë apo tronditje serioze të cilësisë, thelbit e identitetit të marrëdhënies perëndimore. Dhe kjo është shumë e rëndësishme. Pavarësisht se si do të evoluojë më tej marrëdhënia perëndim, në të dy pjesët integrale të tij, SHBA-BE, esenciale është se përmbajtja natyrore, cilësia dhe epërsia e modelit të zhvillimit do të përcaktojë edhe pasurimin e marrëdhënies. SHBA ka udhëhequr Perëndimin dhe ka marrë edhe përgjegjësitë kryesore të sigurisë së Aleancës. Sot duket se po piqet nevoja e mundësia edhe për një rol konkret përmbajtësor të BE-së në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ato që bashkojnë SHBA dhe BE janë shumë më të mëdha, cilësore dhe esenciale nga ato që i dallojnë apo i ndajnë. Forma që do të marrë marrëdhënia mes SHBA dhe BE do të dëshmojë edhe nivelin e evoluimit të ri të Perëndimit dhe modelit Perëndimor të zhvillimit. Njerëzimi do të bëjë hapa përpara përmes ngritjes së zhvillimit në një nivel më të lartë. Për këtë arsye, mbrojtja e modelit perëndimor, përsosja e tij, aktualisht përbën një nevojë historike, siç përbën sot nevojë një Perëndim i bashkuar në formën dhe mënyrën më funksionuese dhe një rol aktiv e udhëheqës i tij në zhvillimet botërore. Nuk mund të mendohet, në interes të zhvillimit e stabilitetit të rendit botëror një kundërvënie brenda Perëndimit, siç nuk ka asnjë nevojë që Europa të kundërbalancojë unilaterizmin hegjemonik të SHBA. Brzezinski kishte të drejtë kur nënvizonte, se Amerika dhe Europa së bashku mund të jenë forca vendimtare që i kontribuojnë zhvillimit të njerëzimit, ndërsa të ndarë apo në një garë, apo më keq në kundërvënie mes tyre, do të shkaktonin pasoja të rënda të së sotmes dhe të së ardhmes së qytetërimit në botë. Perëndimi mund ta luajë këtë rol, sepse ka modelin më të avancuar të zhvillimit, sistemin e vlerave të sendërtuara, përvojën e pasur dhe potencialet komplekse të nevojshme.

Opinioni i Ditës

# Gjermania flet 2018, po ne?

Nga Jorgji Kote

*(vijon nga faqja 1)*



... masive publike "Gjermania flet 2018" (Deutschland spricht 2018). Falë rëndësisë së saj të madhe, kjo veprimtari këtë radhë do të zhvillohet nën patronazhin e lartë të Presidentit Federal gjerman, Frank - Walter Steinmeier. Ky i fundit, krahas Kancelares Merkel njihet si politikan model në drejtim të komunikimit dhe të folurit publik.

Me këtë rast, gjermanët, brenda dhe jashtë vendit janë ftuar qysh në muajin gusht që me përgjigjet ndaj disa pyetjeve themelore mbi aktualitetin politik të vendit të përcaktojnë idetë dhe mendimet e tyre politike mbi pesë aspekte themelore - nëse ndihen më mirë tani se më parë, azilin, sigurinë e kufijve të brendshëm, tatimit të disa produkteve dhe qëndrimeve ndaj Presidentit amerikan, Donald Trump.

Mbi këtë bazë janë përzgjedhur 10.000 çifte, nga 600 vitin e kaluar me ide dhe mendime të ndryshme/kundërta politike, të cilët më 23 shtator do të flasin dhe shkëmbejnë mendime me njëri-tjetrin në mjedise publike, studio televizive, në parqe, kafene, në linjë etj., në të gjithë vendin.

"Gjermania flet" merr shtysë nga domosdoshmëria urgjente për një dialog dhe kulturë të re politike, duke filluar nga njerëzit e thjeshtë e deri në majat më të larta të politikës. Dëgjimi i ideve dhe mendimeve të tjetrit, sidomos kur ato janë të ndryshme dhe të kundërta, shprehja e tyre lirshëm me etikë, qetësi, kulturë, pa teprime, ca më pak pa sharje, ofendime dhe sulme personale është bërë kusht i domosdoshëm i përparimit demokratik. Kjo nevojë ka dalë edhe më shumë në pah me përshkallëzimin e populizmit dhe ekstremizmit; këta të fundit po shfrytëzojnë mjeshtërisht atë që konsiderohet si "diktatura e ndjenjave, inatit dhe mllefit" dhe "kulturën e fajësimit" kolektiv të elitave, në vend të debatit dhe arsyetimit logjik. Dihet se për populistët dhe ekstemistët rëndësi nuk ka se çfarë por mënyra si thuhet, jo faktet, por perceptimet, jo brendia, por forma, jo fjala e qetë, por me zë të lartë deri në të bërtitura dhe gjuhën e urrejtjes.

Fatkeqësisht kjo gjuhë rruge, jo detyrimisht me tone të larta, por vrastare dhe ofenduese po shfaqet edhe në ligjërimet publike të disa politikanëve të njohur gjermanë. Kështu, kryeministri i Landit të Bavarisë, Markus Soder duke u referuar krizës së azilit përdorte vend e pa vend derisa iu ndalua nga gjykata termin "turizëm i azilit", duke konsideruar "turistë shëtitës" të gjithë azilkërkuesit, ndonëse shumica e tyre largohen nga flakët e luftës dhe dhunës. Ndërsa Horst Seehofer, ministri i Brendshëm Federal gjerman, lider i Partisë bavareze CSU me rastin e përvjetorit të lindjes në korrik, njoftoi me gëzim se "riktheu 69 afganë, aq sa vjeç mbushi" çka hasi në reagime të ashpra publike.

Në themel të fushatës "Gjermania flet" qëndron fakti se nuk ka të vërtetë absolute dhe me "V" të madhe, se kurrkush nuk e ka "monopolin" "mbi këtë të vërtetë dhe se vetëm mund t'i afrohesh asaj, veçse gjithnjë me fakte dhe argumente bindëse, të shprehura me kulturë dhe qetësi".

Gjithashtu, në kushtet kur bota po ballafaqohet me komplekse të ndërlikuara problemesh, dëgjimi i tjetrit me kulturën e debatit përbën bazën solide për mirëkuptim, mirëbesim dhe për rrjedhojë shmangien e gjuhës arrogante, shpifjeve e sulmeve personale. Ajo niset gjithashtu nga ideja se mendimi i tjetrit mund të rezultojë më i drejtë, ndaj duhet dëgjuar me respekt dhe vëmendje.

Ja përse po theksohet momenti që të "të flasim me njeri tjetrin, dhe jo kundër njëri-tjetrit". Për shkak të globalizmit që ka ndikim dhe në këtë fushë, "Gjermania flet" do t'i kapërcejë kufijtë gjermanë; ajo do të zhvillohet dhe në Norvegji, Suedi, Danimarkë dhe Austri me logon "My country talks" (vendi im bisedon).

Lind me të drejtë pyetja: kur Gjermania, kjo kampione e demokracisë dhe lokomotivë e ekonomisë së Evropës është e shqetësuar dhe ndjen nevojën të flasë dhe bisedojë, po në Shqipërinë tonë, ku këto probleme janë bërë "ulëritëse" edhe sa do vazhdojmë të mos sillemi kështu, por gjithnjë e më shumë të thërrasim dhe bërtasim? Nuk themi ndonjë të re kur përmendim gjuhën që është pak ta quash "të drunjtë" etiketimet dhe sharjet "me libër shtëpie" deri te të bërtiturat, klithmat, ulërimat dhe kacafytjet fizike në jedise të ndryshme publike, private, në familje dhe jetën bashkëshortore. Madje nga përjashtime, duket se këto prirje joqytetare dhe demokratike po bëhen pothuajse rregull; shembullin e japin të parët një numër deputetësh në sallën plenare të Kuvendit dhe në komisione; bashkë ata edhe disa opinionistë i sheh çdo mbrëmje në debatet televizive dhe të shtypit, në bisedat e kafeneve etj., ku bashkëbisedimi degjeneron deri në përplasje dhe dhunë verbale e fizike. Për ironi të fatit dhe tolerancës së pajustifikueshme të moderatorëve të këtyre rubrikave, "fituese" e këtyre sherrnajave mbetet shikueshmëria e lartë!

Sepse kur nuk dëgjohet mendimi i tjetrit, cilido qoftë ai, kur shahesh dhe ofendohesh me "nënë e me babë", fundi asnjëherë nuk i dihet se ç'mund të ndodhë. Për ironi të fatit, sa më shumë shtohen rezolutat, kodet dhe urdhrat, aq më shumë acarohet fjala dhe debati i lirë që po ngjan përherë e më shumë si një mall luksi. Por, edhe aty ku nuk ka klithma e të bërtitura, ekziston prirja që në vend të bisedës dhe shembullit të mirë, të diktohet mendimi i tjetrit, vetëm falë lidhjes me një parti, një biznesi apo çfarëdo shkaku tjetër. Ndaj, shumë ankohen se për ta, këto bashkëbisedime kthehen në një ferr dhe torturë të vërtetë; në vend të ndjejnë kënaqësi, ata "vuajnë" sepse bashkëbiseduesit e tyre duan vetëm të shfryjnë ato çka dëgjojnë, sidomos në rrjetet sociale dhe "fake news" pa kurrfarë reflektimi.

Vështirësia tjetër, sidomos për të rinjtë, qëndron në fetishizimin e rrjeteve sociale dhe të shoqërisë së informacionit; kjo e fundit nuk po kthehet dot në "shoqëri të dijes", por degjeneron në baltë dhe vulgaritet. Intensiteti dhe shpejtësia marramendëse e hapave që duhen hedhur dhe vendimeve përkatëse u lë njerëzve e sidomos të rinjve fare pak ose aspak kohë për të menduar, reflektuar dhe analizuar dukuritë e ndryshme dhe mbi bazën e shkëmbimit të informacionit të përftuar, të nxirret përfundimi më i drejtë.

Shkak tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me kulturën deficitare politike të fjalës dhe bisedës, ndarja si në luftë në "llogore" dhe "istikame" ideologjike e partiakë, duke "qëlluar me breshëri" këdo që del përpara me kundërshtime dhe alternativa të ndryshme, për këtë qëllim nuk e kemi për gjë të vëmë në përdorim një "arsenal gjigant me municion" dhe të hedhim baltë mbi të kaluarën e një personi, pa u ndalur te idetë e tij. Jemi bërë vend tipik ku njerëzit ndahen në "të mirë dhe të këqij, në pozitivë dhe negativë, në miq dhe armiq, apo në ne dhe ata". Së fundi, edhe disa nga politikanët tanë kryesorë, dje dhe sot, me gjithë premtimet nuk kanë arritur të krijojnë, ca më pak të japin shembullin e tyre për forcimin dhe përhapjen e kësaj gjuhë, fryme dhe kulture politike të debatit pa shere, pa paragjykime, epitete dhe metafora ofenduese. Aq sa arti i qeverisjes apo lidershipit po reduktohet në një 'show' dhe garë batutash pa kripë; më shqetësuesja është se edhe shumë politikanë të rinj të shkolluar në Perëndim jo vetëm nuk po bëjnë ndryshimin apo diferencën, siç pritej, por po bien dhe ata në jo pak raste në këtë batak, qoftë dhe thjesht me heshtjen e tyre. Kësisoj, komprometohet edhe shembulli i mirë i politikanëve të tjerë që shquhen për kulturën e komunikimit.

Ja pse "Deutchland spricht 2018" përbën një rast të dobishëm reflektimi dhe pikë referimi edhe për Shqipërinë, për njerëzit e thjeshtë dhe politikanët më të lartë, që të mos bërtasin dhe çirren, por të mësojnë të flasin dhe bisedojnë si në një shoqëri të vërtetë demokratike, ku gjithçka fillon nga fjala; që ajo të mos pengohet, përndiqet dhe burgoset, por edhe të mos jetë "e rëndë si plumbi" e të mos "thyejë kocka". Lajmi i mirë është se kjo nuk kërkon kurse, trajnime, mastera, ndihma, kushte dhe kritere, por vetëm vullnet pozitiv dhe lidership të vërtetë. Ndaj, fushata të tilla si "Gjermania flet 2018" apo edhe me emra të tjerë, janë mëse të nevojshme dhe të mirëpritura edhe te ne.

## HOROSKOPI

### DASHI

Problemet që lidhen me shëndetin mund të shkaktojnë siklet. Sa u përket financave, parashikohet një rritje e të ardhurave nga investimet e kaluara. Për disa, një vizitor në familje sjell momente gëzimi.

### DEMI

Miqtë do t'ju prezantojnë me dikë të veçantë, që do të ketë një ndikim të jashtëzakonshëm në mendimet tuaja. Vështirësitë financiare duket se kapërcehen pasi prindërit tuaj ju japin mbështetje.

### BINJAKET

Një kompliment i veçantë nga një mik do të ishte burim lumturie për ju. Financat do të kenë një përmirësim të lehtë më vonë gjatë ditës. Mundësitë për të treguar aftësitë tuaja do të jenë me ju sot.

### GAFORJA

Hapat e guximshëm dhe vendimet pa frikë do të sillnin shpërblime të favorshme. Sot është një nga ato ditë kur gjërat nuk do të lëvizin ashtu siç dëshironi, nëse nuk tregoheni të zoti. Mbrëmja do të jetë romantike.

### LUANI

Mendohuni dy herë para se të flisni. Padyshim që pikëpamjet tuaja mund të dëmtojnë ndjenjat e dikujt. Investimet në aksione janë të rekomanduara për përfitime afatgjata. Sot mund të merrni një propozim pune, që keni dashur gjithmonë ta bëni.

### VIRGJERESHA

Ju do të keni energji me bollëk, por presioni në punë duket se ju bën të acaruar. Nuk është një ditë shumë e dobishme, prandaj kontrolloni situatën tuaj të parave dhe kufizoni shpenzimet tuaja.

### PESHORJA

Orari i tejzgjatur në punë mund t'ju bëjë të rraskapitur. Në çift zgjidhini problemet personale, duke kuptuar pikëpamjen e njëri-tjetrit. Mos i nxirrni problemet tuaja në publik, sepse mundësitë për t'u përballur me shpifje do të jenë të mëdha.

### AKREPI

Sot do të ndiheni të relaksuar dhe në humorin e duhur për të shijuar gjithçka që ju ofron jeta. Një ditë e mirë për të ringjallur kontaktet dhe marrëdhëniet e vjetra. Mjedisi juaj i punës mund të ndryshojë për mirë sot.

### SHIGJETARI

Pozicioni i parasë përmirësohet pasi pagesat e vonuara do të rikuperohen. Do të shihni se ëndrrat tuaja do të do të realizohen. Të qenit hakmarrës ndaj partnerit tënd nuk do të sjellë ndonjë rezultat, përkundrazi.

### BRICJAPI

Financat me siguri do të kenë një rritje, por në të njëjtën kohë edhe shpenzimet nuk do të jenë të vogla. Zgjidheni sot një grindje të vjetër, sepse nesër mund të jetë shumë vonë.

### UJORI

Suksesi nga disa sipërmarrje të kaluara do t'ju ngrejë besimin. Paratë këshillohen që të investohen në pasuri të paluajtshme. Miqtë do t'ju vijnë në ndihmë, nëse është e nevojshme. Do të kuptoni sot se dashuria e partnerit tuaj është me të vërtetë shpirtërore.

### PESHQIT

Është dita juaj me fat në dashuri. Partneri do t'ju habisë me realizimin e fantazive të shumëpritura. Jini të kujdesshëm që të mos bëni komente të ashpra në vendin e punës. Duket se partneri juaj është në humor të shkëlqyer sot.

## Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Një pjesë e perandorisë
4. Duhen marrë kolegjialisht.
11. Qytet rus
13. Fillojnë daljen.
14. Të lë në mëdyshje.
15. Një pjesë teatrale për të qeshur
17. Eshtë publiku i San Siros.
18. Janë botimet e përmuajshme.
20. Mbyllin aeroporte.
21. Në krye të titullarëve.
22. Ishte gruaja që i dha ujë nga pusi Krishtit
25. Bëjnë zoom të tillë.
27. Inicialet e Kazan regjisor.
29. Centrale Autonome Daneze.
30. Eshtë e kundërt e analizës.
31. Qe mjeku i Mark Aurelit.
33. Një enë
34. Pulat pa kufij.
35. Eshtë për të ushqyer foshnjat me qumsht.
38. Emri i Pirandellos.
40. Një fjalë si akoma
41. Në mes të Salt dhe City
42. Jean që qe aktor.
45. Mbyllin takimet
46. Eshtë edhe ajo e cirkut
47. Kapiteni i Nautilus.
48. ... mosketierët e Dumas.

VERTIKAL
1. Një fjalë e pamjaftueshme.
2. Qe fabulist i famshëm
3. Janë ciganët.
4. Hapin vallen.
5. Eshtë influencim.
6. Janë amatorët
7. Pak ilaritet
8. Një pjesë e mendimeve.
9. Eshtë budallaçka.
10. Një fjalë e freskët.
12. Një emër i njohur i modës.
13. Me Odiseun u vodhi Palladin trojanëve.
16. Elvira aktore.
17. Pal... ish futbollist i yni.
19. Një pjesë i dardanëve.
21. Eshtë marsejeze... për çati.
23. Eshtë ylli më i shndritshëm i Akrepit
24. Liam aktor
26. Mund të jetë një koncert.
28. Kështu flet ai që është mbi kalë.
32. Janë shtetet e ndara nga feja.
35. Sean aktor.
36. Stoker që shkroi Dracula.
37. Një që bëhet si favor.
39. Tre në Genesaret.
43. Mbarojnë fare
44. Diftong për serioz.

## Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Irene aktore.
6. Gjysma e kulmit.
8. Fillojnë vetëm.
10. Qytet rumun
11. Mund të jenë me sahat.
13. Elliott Gould.
14. Inicialet e Altman regjisor.
15. Thomas Alva shpikës i famshëm.
16. Lumë në Spanjë.
18. Ndaheshin me sinorë.
20. Zbuloi Tokën e Van Diemen.
22. Kush nuk ka... nuk i ecën.
23. Një kapak me titull.
25. Inicialet e Turgeniev.
26. Janë provat që administrohen.
28. Na kanë paraprirë .
30. Rubinstein që qe pianist.
31. Fundi i një fukarai.
32. Gardner aktore.
33. Këndon me Paolan .
34. Mish pa kocka.
36. Mbahet në fund.
37. Diftong teorik.
38. E drejta romake.
40. Eshtë transporti si kamion.
42. Eastwood i kinemasë.
45. I vocërr ai i Migjenit.
47. Eshtë numri 1.
48. Eshtë aftësia e kondensatorit
49. Janë ciganët.



VERTIKAL
1. Eshtë material për qiri.
2. Mali ku ngeci Arka e Noes.
3. Fillojnë panikun.
4. Një zakon.
5. Gjysmë sistem.
6. Janë zogj të verdhë .
7. Në fund të krahut.
8. Shkroi Michel Strogoff.
9. Gjysmë egoist.
11. Përbindëshi i labirintit.
12. Vertetojnë firma të tillë.
16. Emri i Zola.
17. Eshtë si shtëpi.
19. Mbyllin portat.
21. Ka tribuna me shkallë.
23. Mund të jetë telefonike.
24. Charles që krijoi Gishton.
26. Pineda e Garcia Lorca-s.
27. Janë të palëvizshmet.
28. Aty ku del kush bie në sy.
29. Ashtu si jeton anakoreti.
33. Coca... më e famshme.
35. Janë të ndryshme në leje.
37. Ente Civile Kavajë.
39. Shkroi Misteret e Parisit.
41. Beton pa kufij
43. Kështu përfundon një princip.
44. Inicialet e Cruise .
46. Kufizojjë lëvizjet.

## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2 | | | | | 1 | 3 | |
| 8 | | | | 6 | | | 9 | |
| | | | 5 | | | 4 | | |
| 6 | | | | 8 | | | | 1 |
| | | | 4 | | 5 | | | |
| 7 | | | | 3 | | | | 5 |
| | | 8 | | | 4 | | | |
| | 9 | | | 2 | | | | 8 |
| | 1 | 3 | | | | | 6 | |

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | 5 | 1 | 6 | 4 | 9 | 8 | 3 | 2 |
| 8 | 9 | 2 | 7 | 5 | 3 | 1 | 6 | 4 |
| 3 | 6 | 4 | 2 | 8 | 1 | 5 | 9 | 7 |
| 9 | 1 | 5 | 8 | 6 | 7 | 2 | 4 | 3 |
| 2 | 7 | 3 | 5 | 9 | 4 | 6 | 8 | 1 |
| 4 | 8 | 6 | 1 | 3 | 2 | 7 | 5 | 9 |
| 1 | 4 | 8 | 9 | 7 | 5 | 3 | 2 | 6 |
| 5 | 2 | 9 | 3 | 1 | 6 | 4 | 7 | 8 |
| 6 | 3 | 7 | 4 | 2 | 8 | 9 | 1 | 5 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR



FJALEKRYQI (1)

FJALEKRYQI (2)

## Argëtim filozofik



- Ankthi nuk na shkëput dhimbjen për nesër, por na privon lumturinë për sot!!
  **Charles H. Spurgeon**
- Mendjet e mëdha diskutojnë idetë, mendjet mesatare diskutojnë ngjarjet, mendjet e dobëta diskutojnë për të tjerët.
- Ju keni për të gjetur në mesin e mendimeve të vogla që na shqetësojnë, rrugën e mendimeve të mëdha që të na japin forcë!!
  **D. Bonhoeffer**

## KRIPTOSKEME



## KRIPTOSKEME
*Përgjigja e numrit të djeshëm*



## Thënie të mençura

- Zakonisht njerëzit jo dhe aq gëzojnë për ato që kanë, se sa hidhërohen për ato që nuk kanë.
- Në fund, e vërteta do të fitojë, mjafton të thotë disa gënjeshtra.
- Lumturia e jetës, varet nga kualiteti i mendimeve tuaja!!
- Bota është mjaft e madhe për të përmbushur nevojat e çdo njeriu, por është shumë e vogël për të kënaqur lakminë njerëzore.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQËRISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
Brikena Duva:
VIP
BLUE TOOTH
Përballë shtet dhe zjarrit
Ndaj Piramida duhet të jetë BIBLIOTEKË KOMBËTARE
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al